



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4996 /2023

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hani të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e gjashtë -VI- të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 29.06.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026.
3. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hani të Elezit për vitin 2022.
4. Plani i Veprimit të Komunës për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hani të Elezit për vitin 2022.
5. Kërkesa për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.
6. Plotësim-ndryshim të vendimit Nr.01/1116 kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga 2022 në vitin 2023.
7. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.
8. Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Hani të Elezit 2023 – 2025.
9. Draft Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hani të Elezit.
10. Draft plani i veprimit për Transparencë 2023-2026 i Komunës së Hani të Elezit.
11. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e Kornizës afatmesme buxhetore 2024-2026.
- Materialin e Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hani të Elezit për vitin 2022.
- Materialin e Planit të Veprimit të Komunës për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hani të Elezit për vitin 2022.
- Materialin e kërkesës për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.
- Materialin e Plotësim-ndryshim të vendimit Nr.01/1116 kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga 2022 në vitin 2023.
- Materialin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.
- Materialin e Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Hani të Elezit 2023 – 2025.
- Materialin e Draft Strategjisë për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hani të Elezit.
- Materialin e draft planit të veprimit për Transparencë 2023-2026 i Komunës së Hani të Elezit.

Hani i Elezit
Data:-19.06.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5997 /2023
Data: 19.06.2023

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e pestë -V- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.05.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Draft Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hanit të Elezit.
3. Draft plani i veprimit për Transparencë 2023-2026 i komunës së Hanit të Elezit.
4. Plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës.
5. Rishqyrtimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave.
6. Plotësim-ndryshimi i vendimit nr 01/Nr.1116/2023 kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023.
7. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Draft Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- është strategji e komunës që me avancuar me hapa më të shpejtë për pjesëmarrje të qytetarëve për komunikim të drejtë dhe informim të vazhdueshëm në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e qytetarëve. Në strategji janë të paraqitura objektivat si mekanizma të cilat do të përdoren.

Resul Suma thekson:- vendosja e monitorëve në zonat urbane është në rregull por nëse vendosen në zonat rurale besoj që do të dëmtohen dhe investimi do të shkon në dëm me një herë

Natyra Kalisi thekson:- do të vendosen në ato pika që kanë me u vërejt edhe prej kamerave të sigurisë që janë edhe nëpër zona rurale dhe po mundohemi me rritë vetëdijesimin e qytetarëve në mënyrë që mos me i dëmtuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU STRATEGJIA PËR INFORMIM KOMUNIKIM DHE PJESEMARRJE QYTETARE 2023-2026 TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

3.Draft plani i veprimit për Transparencë 2023-2026 i komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- është një plan që është hartuar në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe kolegjiut për transparencë. Është mbajtur punëtori në bashkëpunim me OSB-në dhe është shtjelluar me grupin punues. Materiali është përcjell me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë informacion prej Ministrisë përkatëse për çështje të kompensimit të këshillave të fshatrave.

Natyra Kalisi thekson:-plani për transparencë dhe strategjia i përfshinë këshillat e fshatrave dhe Ministria e ka dërguar një qarkore për çështje të komisioneve. Në javën e kaluar kemi pasur një takim me Demosin dhe e kemi ngritur si çështje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU DRAFT PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË 2023-2026 I KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

4. Plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:-plotësim ndryshimi i statutit i ka kaluar të gjitha fazat dhe procedurat ligjore. Materialin e keni para juve nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- a është planifikuar me buxhet në këtë drejtori edhe stafi përcjellës dhe për cilin vit. Drejtori a do të jetë politikë apo i përhershëm.

Hisni Luri thekson:- po planifikojmë që prej vitit 2024 që të fillon të ndahet si çdo drejtori tjetër, të ketë stafin e vetë dhe buxhetin ta ketë ndaras veçmas. Drejtori i kulturës do të jetë politik , ndërsa menaxheri do të jetë me akt emërim të përhershëm.

Resul Suma thekson:- pjesa e drejtorisë që hapet i bien me qenë edhe menaxher i shtëpisë së kulturës dhe drejtori me qenë me zyre këtu në komunë.

Hisni Luri thekson:- në momentin që do të ndahet drejtori do të jetë me staf dhe pjesë e stafit do të jetë një menaxher i Shtëpisë së Kulturës i cili do të merret me organizatat rinore dhe organizatat tjera.

Sherif Berisha thekson:- komuna e Prizrenit e ka vetëm drejtorin që bënë pjesë për arsim kulturë rini dhe sport, e që të gjithë e dimë që Prizreni sa banorë i ka, ndërsa komuna jonë e dimë sa banorë i ka dhe vetëm sa për me rehatuar dikend si Lëvizje Vetëvendosje jemi kundër.

Hisni Luri thekson:- në komunën e Prizrenit ka drejtor të teatrove të cilët e kanë koeficientin e pagës sa një drejtor politik që është në komunën tonë por kjo është çështje e juve që mendoni në atë formë dhe nuk dua me ua arsyetuar bindjet e juaja por ka komuna më të vogla se na e që e kanë drejtorinë e kulturës të ndarë prej arsimit. Këtë po e bëjmë që me funksionuar më mirë dhe sa i përket rehatimit nuk e dimë se kush do të vjen drejtor dhe kush do që vjen uroj që të jetë profesional . Komuna e Prizrenit e ka të ndarë drejtorinë e kulturës veç prej arsimit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 12 për , 1 kundër, 1 abstenim.

U MIRATUA PLOTSIM NDRYSHIMI I STATUTIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

5. Rishqyrtimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- bëhet fjalë për vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të disa parcelave të cilin e ka miratuar kuvendi i komunës në muajin Mars të këtij viti. Bëhet fjalë për te fusha e futbollit afër lagjes së vlashëve, parcela që planifikohet për ndërtimin e një shkollë në Lagje të re dhe te ura e Fezës. Ju e keni shkresën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që e ka dhënë arsyetimin që parcelat publike me u votuar veç dhe privatet veç.

Refet Kalisi thekson:- vërejtje kam për drejtorin e urbanizmit për shkak se e ka stafin e tij dhe është dashur me i shikuar mirë që mos me na u kthyer në rishqyrtim vendimi.

Nexhmedin Daci thekson:- nuk kemi pasur njohuri që për pronat private duhet një vendim në veti dhe për pronat të cilët janë në menaxhim të AKP-së vendim në vete.

Kryesuesi thekson:- si material është pak i mangët për shkak se ke mundur me i dërguar edhe ortofotot në mënyrë që asamblistët të jenë më të informuar. Është dashur të konsultoheni me zyrtarin ligjorë për këtë çështje.

Zaim Bela thekson:-për këtë vendim herën e kaluar kam abstenuar për shkak se nuk jam pajtuar me do sende të tjera. Në shkresën të cilën na është dërguar prej Ministrisë shënon se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe duhet të votohet secila pronë veç e veç.

Nexhmedin Daci thekson:-zyrtari ligjorë ka komunikuar me Ministrinë dhe i kanë sugjeruar që pronat private me një vendim në vete ndërsa , shoqërore me një vendim në veti.

Sherif Berisha thekson:- është dashur të konsultoheni me zyrën ligjorë për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka pronat shoqërore i hedh në votim; rezultati i votimit ishte 9 për , 5 abstenim. Pronat private i hedh në votim; rezultati i votimit ishte 9 për , 5 abstenim.

U MIRTUA RYSHQYRTIMI I VENDIMIT PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PARCELAVE

6. Plotësim-ndryshimi i vendimit nr 01/Nr.1116/2023 kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- materialin e keni të shënuar në mënyrë detale dhe është plotësim ndryshim i vendimit 01/Nr.1116/2023 kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023.

Zaim Bela thekson:- sa është shuma e mjeteve financiare të cilat nuk kthehen dhe është mirë që këto mjete të shpenzohen për shkak se kam dëgjuar shuma prej 100 € e tatimit në pronë a do të ju falet qytetarëve.

Lindita Ballazhi thekson:- diferenca e mjeteve është në shumë prej 10,000 € . Sa i përket tatimit në pronë deri më tani nuk kemi pranuar ndonjë vendim.

Sherif Berisha thekson:-pse është vonuar shpërndarja e faturave të tatimit në pronë.

Lindita Ballazhi thekson:- i kemi pranuar faturat e tatimit në pronë nga departamenti i tatimit në pronë nga Ministria e Financave dhe kemi dashur dhe kemi dashur me i kontraktuar dy apo tre persona me kontratë në vepër por nuk ka pasur të interesuar për ta kryer këtë shërbim , ndërsa për me i shpërndarë me postë ka qenë e kushtueshme dhe ka pasur ankesa nga qytetarët se faturat nuk janë shpërndarë te personat e caktuar , mirëpo zgjidhja tjetër ka qenë që me zyrtarët komunal me i shpërndarë faturat, jemi munduar që me i koordinuar punët dhe kemi arritur që 95 % të faturave me i shpërndarë brenda afatit kohorë. Afatet kohore dihen se kur janë dhe ka qytetarë që nuk e presin afatin kohorë.

Refet Kalisi thekson:- kërkoj sqarim të rregullimi parkut të rruga “Isa Berisha” asfaltim , trotuarë, ndriçim publik.

Nexhmedin Daci thekson:- bëhet fjalë për parkun “Isa Berisha “ sepse se vitin e kaluar nuk i ka kryer punimet për shkak se nuk është kryer pagesa pa i kryer punimet dhe ato mjete që ishin të parapara për vitin e kaluar janë bartur në këtë vit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I VENDIMIT NR 01/NR.1116/2023 KËRKESË PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË PA SHPENZUARA NGA VITI 2022 NË VITIN 2023

7. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe po ashtu edhe raportin nga kompania "Sharrcem" e keni të bashkangjitur

Refet Kalisi thekson:- kompania "Sharrcem" duhet t'i mbjell etazhet që e ka marr lëndën e parë . Është gurthyesi i Seçishtës pastaj gurthyesi tjetër dhe ka ndotje të ambientit e duhet të kontrollohen. Kompania "Sharrcem" para dhjetë viteve dy etazhe i ka rregulluar dhe i ka ndërprerë . Komuna duhet të jetë në kontakt që me pyllëzuar atë pjesë.

Sherif Berisha thekson:- sa i përket ndotjes të gjithë e dimë që ka ndotje. Kërkoj që të jetë një monitorues nga komuniteti për shkak se Ligji e lejon. Edhe në KPF e kam diskutuar që gjashtë mijë tonë në orë pjekën dhe ajri ku shkon për shkak se ne nuk jemi profesional që t'i bëjmë analizat. Kërkoj nga grupet parlamentare që të më përkrahin për me caktuar një monitorues të komunitetit që të jetë i përhershëm.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket etazheve ende kanë me punuar për shkak se e kanë planin për pesëmbëdhjetë vite dhe sipas informatave që kanë afër 1200 drunj i kanë mbjell në to vende ku nuk punohet. Kompania "Sharrcem" e ka lejen e integruar dhe janë inspektorët e Ministrisë të cilët bëjnë kontrole të rregullta me të cilët kemi një bashkëpunim të mirë dhe së bashku me inspektorët tonë kanë bërë inspektime dhe i kanë dhënë vërejtje. Në aspektin ligjorë janë në rregull por nuk do të thotë që nuk ka ndotje për shkak se problemin e kanë kur bëhet shkarkim ngarkimi dhe me cisternat dhe kur fryn era.

Sherif Berisha thekson:- është në rregull ju që e thoni këtë por edhe kërkesa ime është e drejtë sepse neve na intereson komunitete e pse mos me pasur një monitorues brenda prej komunitetit. Ndotje dhe po që se në mbremje e parkon veturën jashtë në mëngjes nuk mundesh me pastruar me ujë të thjeshtë por me ufëll. Unë i bëra këto vite dhe po më intereson për gjeneratat e reja. Kompania "Sharrcem" është private dhe është mirë që e ka zvogëluar ndotjen por neve na intereson mos me pas ndotje.

Nexhmedin Daci thekson:- kompania "Sharrcem" i ka të vendosur filterat dhe ka me tentuar që me mundur një grup prej juve me shkuar në vizitë dhe me u informuar në vend në mënyrë që me pasur informacione më shumë.

Kryesuesi thekson:- sipas analizës së drejtorit kur diskutohet për ndotje ne duhet me ndërtuar fabrika dhe shtëpitë duhet me i zvogëluar për shkak se kur bisedohet për ndotje potencon që shtëpitë gjatë dimrit, veturat e që unë nuk e shohë të arsyeshme për shkak se ndotja prej ndotjes ka dallim për shkak se grimcat PM 2.5 dallojnë prej ndotjes së një shtëpie që përdorë masë drusore për me u nxehtë gjatë sezonës dimërore. E dimë që kompania "Sharrcem" ka filluar me u përmirësuar por nuk është për me i dhënë lëvdata por duhet të tentojmë që vazhdimisht me përmirësuar ambientin. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Xhevahir Dernjani thekson:- çështja e defekteve të ujit afër ambulancës a është rregulluar për shkak se edhe në qeverisjen e kaluar ka pasur probleme. Deri ku kanë mbërri punimet me çështje të ujit. Është mirë që të shtrohet rruga e cila quhet Llashtica për shkak se janë disa shtëpi dhe kanë familje dhe deri më tani nuk është shtruar. Duhet hapet dhe shtrohet rruga për lagjen e cila është te rezervarët e ujës jellësit të ujit të Dimcës.

Erbli Meliqi thekson:- e përgëzoj drejtorinë e shëndetësisë për shtimin e stafit të infermierëve. A kanë filluar me punuar infermierët të cilët i keni pranuar dhe a ka pasur ankesa nga ata të cilët nuk janë pranuar.

Arsim Dernjani thekson:- sa i përket defekteve janë rregulluar gjitha , kurse për çështje të ujit kemi pasur disa takime dhe nesër do të kemi takim me CDI-në, Bifurkacionin dhe kompaninë Teuta dhe shpresojmë që menaxhimi i ujit do t'i kalon Bifurkacionit.

Sevdi Dernjani thekson:- sa i përket rrugës te Currt prioritet është të ndërtohet rruga deri te fabrika e ujit dhe pastaj të shikohen mundësitë buxhetore për me shtruar edhe rrugën për shkak se ka qenë kërkesë nga banorët në dëgjimet buxhetore të cilat i kemi pasur në vitin e kaluar.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- ankesa ka pasur dhe i kam orientuar te Karitasi për shkak se procedurat janë zhvilluar përmes prokurimit dhe fitues ka qenë Karitasi dhe ka bërë përzgjedhjen.

Kryesuesi thekson:- nuk do të ishte mirë që dikush pranohet dhe e vesh mantelin dhe pastaj me ju hequr për shkak se është keqë për atë person se nuk ka rëndësi se kënd e pranon por me rëndësi është që ai i cili pranohet ne të vazhdon punën dhe ne të ketë sukses. Sa i përket specializimit që parashihet për dy mjekë prej komunës sonë por a ka ndonjë kriter se si do t'i paguan komuna.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- Ministria përkatëse i ka planifikuar pesë pozita për specializim por interesim ka pasur për biokimi dhe për radiolog. Kriteret nuk përcaktohen në bazë të komunës por i përcakton Ministria dhe gjithë secili e ka të drejtën për me aplikuar dhe aplikimi është onllajnë, përzgjedhja bëhet përmes Ministrisë por mbështetje është vetëm për dy persona nga ana jonë.

Kryesuesi thekson:- a ka mundësi që komuna me ja caktuar ndonjë kriter që pesë apo dhjetë vite me punuar në Han të Elezit.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- me Udhëzim Administrativ përcaktohen kriteret dhe parashihet që sa vite komuna kontribonë për specializantët dhe atë kontribut duhet me për pesë vite në QKMF-në tonë.

Resul Suma thekson:- kamerat e kaluara kanë qenë me kualitet 4.0 ndërsa tash janë blerë me kualitet 2.0 , ndoshta nuk ka pasur buxhet por më mirë është dashur me prit më shumë dhe me i blerë të njëjta dhe me i rregulluar ata të vjetrat e jo me blerë kualitet më të dobët. Në fund vitin 2021 është dhënë donacion një autobuse nga një bashkatdhetarë i yni në Gjermani. Autobusi qëndron në Terminalë dhe janë tu ja vjedhë pjesët, pse autobusi rrinë aty se është mirë me shërbyer për klubin e Sharrit , mundjes apo OJQ-të e ndryshme. Është koha e kornizës afat mesme buxhetore dhe pse në komunën tonë nuk hapen konkurse për avancim për shkak se në të gjitha komunat e tjera punëtorët motivohen , stimulohen dhe avancohen në detyrë. Në komunën tonë nuk ka asnjë konkurs për ndonjë punëtorë që ka treguar rezultate të mira.

Sevdi Dernjani thekson:- për çështje të kamerave drejtoresha në Kuvendin e radhës do të përgjigjet. Autobusi nuk i plotëson kriteret për me i bartur ekipet e futbollit jashtë vendit dhe për atë arsye është në atë gjendje që ka mbetur . Edhe nga qeverisja e kaluar nuk ka qenë në funksion por as tash, kemi provuar përmes ankandit me shitur por nuk ka pasur oferta.

Lindita Ballazhi thekson:- ne jemi shumë pro që me u avancuar stafi aktual i komunës e kjo bëhet përmes trajnimeve, ndërsa për ngritje në detyrë duhet të kesh pozita të lira e këto pozita na i aprovon Ministria .

Hyriete Isufi thekson:- para tri jave ka qenë kompania e cila merret me çështje të printerëve por ende nuk ka ardhur me i rregulluar për shkak se kemi edhe një muaj mësim. Pagesat për orët shtesë që i kam mbajtur për gjashtë muaj nuk më është bërë pagesa. Kemi nevojë për psikolog të rregullt nëpër shkollë i cilët punojnë direkt me nxënës .

Hisni Luri thekson:- çështja e printerëve është çështja e kompanisë që është e centralizime prej Ministrisë të cilën e kemi me qira. Problem kemi pasur edhe në administratën komunale vazhdimisht kemi bërë kërkesë kompanisë për me i rregulluar. E vetmja mundësi është për me i funksionalizuar printerët të cilët i kemi pasur nëpër shkolla. Për çështje të pagesës vazhdimisht kam tentuar me i kryer por nuk kemi mundur dhe duhet me bërë një marrëveshje në mënyrë që me i kryer për shkak se kësi probleme kemi edhe me mësimdhënës tjerë. Me ligj të arsimit duhet të i kemi mbi 1000 nxënës në mënyrë që me pasur një psikolog dhe kemi planifikuar që t'i kemi dy pozita si psikolog të rregullt .

Hanumshahe Dibrani thekson:- nxënësit e shkollës fillore “Ilaz Thaqi” të klasës së pestë janë dërguar në shëtitje dhe pse nuk janë dërguar edhe nxënësit e shkollave të tjera në shëtitje.

Hisni Luri thekson:- shkollat janë të ndara dhe e kanë nga një menaxher secila shkollë dhe me udhëzimin e ri për shëtitje një ditore nuk pyetet drejtorja e arsimit për shkak se këto kompetenca i ka shkolla.

Refet Kalisi thekson:- isha me një varrim në fshatin Dimcë e rrugët ishin zënë nga bari dhe duhet përmes kompanisë duhet të pastrohen. Mjetet financiare a janë të gjitha të karitasit apo ka edhe prej Komunës dhe si ka drejtë karitasi me bërë përzgjedhjen e drejtorëve.

Arsim Dernjani thekson:- këto dit kompania ka qenë e angazhuar me problemet e ujësjellësit dhe do të bëhet pastrimi i rrugëve.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- sa i përket Karitasit kemi zhvilluar si procedurë përmes prokurimit dhe në momentin që ka fituar kompania nuk kemi të drejtë me ndërhyrë. mjetet financiare janë të gjitha të komunës dhe Karitasi e ka bërë përzgjedhjen.

Malik Berisha thekson:- a do të shtohet stafi apo do të mbetet vetëm me katër infermierë.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:-janë të ndara 30 000 € për shkak se këto mjete ishin të planifikuara që me bërë marrëveshje me “Islamik Reliefin” por ata nuk kanë shprehur interesim dhe procedurat i kam zhvilluar përmes prokurimit. Ditën e premte bëhet dhurimi i gjakut dhe ju bëjë thirrje që t'i informoni qytetarët.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi





Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Komuna – Municipality

Hani i Elezit



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

04/_____/2023

Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës Hani i Elezit për vitet 2024-2026

HANI I ELEZIT, QERSHOR 2023

Lista e shkurtesave:

AK	Administrata Komunale
BE	Bashkimi Evropian
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
BK	Buxheti i Komunës
DBK	Departamenti i Buxhetit Komunal
DBF	Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
DAKRS	Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
DSHPE	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
DUKMM	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
DZHET	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit
DBPZHR	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FKBRK	Fondi i Komunave nga Buxheti i Republikës së Kosovës
GP	Granti i Përgjithshëm
GSA	Granti Specifik i Arsimit
GSSH	Granti Specifik i Shëndetësisë
IPA	Instrumenti për asistencë Para-Anëtarësimit
KABK	Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KG	Komisioni i Granteve
KESH	Klasifikimi Ekonomik i Shpenzimeve
LFPL	Ligji i Financave të Pushtetit Lokal
LMFPP	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LVQL	Ligji për Vetëqeverisjes Lokale
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
PIP	Programi për Investime Publike
PPP	Partneriteti Publiko – Privat
PRRU	Plani Rregullues Urban
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
QBB	Qarkorja e Brendshme Buxhetore
RGJB	Rishikimi Gjashtëmuor i Buxhetit
SZHMB	Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
THVK	Të Hyrat Vetanake Komunale
THV	Të Hyrat Vetanake

PJESA E PARË


SHQYRTIMET HYRËSE

Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Hanit të Elezit (KABK 2024-2026), paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026, i cili do të miratohet nga Asambleja Komunale.

Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për Institucionet Buxhetore Komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2024-2026 të pranuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së resurseve Komunale për periudhën 2024-2026. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme :



Vlerësimet e hershme janë elementet kryesore në përgatitjen e projeksioneve indikative buxhetore për vitin 2024 dhe do të shërbejnë si projeksione edhe për vitet 2025-2026. Vlerësimet e hershme janë në veçanti të rëndësishme për shqyrtimin adekuat të shpenzimeve operative dhe kapitale.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezentimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026 dhe
- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet nga OB-të në nivel qendror dhe lokal zbatimit të çështjeve në vijim, si:
- OB-të të mos propozojnë aktivitete apo projekte të reja pa i dhënë prioritet buxhetimit të obligimeve për aktivitetet/projektet kapitale,
- Në përputhje me rekomandimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, OB-të të deklarojnë në MFPT obligimet që kanë ndaj kontratës kolektive;
- Në përputhje me rekomandimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit OB-të të dërgojnë në MFPT informatë lidhur me paditë e ngritura lidhur me paditë e ngritura së bashku me një vlerësim nga zyrat ligjore për mundësinë e materializimit/shndërrimit të tyre në obligime;
- OB-të në nivel qendror dhe lokal të deklarojnë në MFPT numrin e pozitave të lira e të paplotësuara për të cilat OB nuk ka marrëdhënie punësimi dhe për të cilat nuk ka buxhet për plotësimin e tyre.
- OB-të janë të obliguara të plotësojnë të dhënat që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP si dhe duhet të eliminojnë keq klasifikimet të shpenzimeve buxhetore. Nëse me rastin e dorëzimit të propozim buxhetit nga OB qendrore apo lokale analisti buxhetor do të identifikojë keq klasifikimet, Departamenti i Buxhetit të njëjtat do t'i largojë nga buxheti, duke përfshirë jo vetëm keq klasifikimet për projektet e reja por edhe ato që janë në vazhdimësi nga viti i kaluar;
- Projektet e propozuara të jenë projekte në përputhje me Manualin e PIP dhe UA për **Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale** si dhe **UA për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale**. Projektet të cilat nuk zbatojnë kërkesat kryesore të manualit dhe udhëzimeve administrative, nuk do të lejohen të bëhen pjesë e buxhetit.
- Me rastin e propozimit të projekteve të reja kapitale, OB-të të dorëzojnë në MFPT arsyeshmërinë për secilin projekt sipas manualit të PIP dhe udhëzimeve administrative, që përfshinë edhe kriterin e përputhshmërisë së projektit/aktivitetit të propozuar me strategjinë dhe KASH-in 2024-2026;

- Regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në SIMFK;
- Ministritë duhet të ndajnë mjete buxhetore brenda hapësirës fiskale vetëm për realizimin e atyre projekteve kapitale për të cilat në bazë marrëveshjeve të mirëkuptimit me komunat kanë krijuar obligime në të kaluarën. Nuk do të lejohen projekte të reja në nivel qendror të cilat sipas legjislacionit në fuqi janë kompetenca komunale;
- Buxhetimi i projekteve kapitale të bëhet në përputhje me **Udhëzimin Administrativ për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale**, ku pjesë e koston së projektit janë edhe *shpenzimet e shpronësimit*. Organizatat buxhetore qendrore dhe lokale, pas një analize paraprake, duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo projekt individual në kuadër të koston totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.
- Për projektet e reja kapitale të natyrës teknologjisë informative Organizatat Buxhetore para se të aplikojnë për mjete buxhetore duhet të marrin miratim paraprak nga Agjencia e Shërbimit të Informacionit- ASHI (MPB) se një projekt të tillë nuk mund të zbatohet nga ASHI-ja.

Burimet e Financimit Komunal për vitin 2024-2026

Struktura e financimit komunal përfshin:

- ❖ Grantin e përgjithshëm,
- ❖ Grantin specifik për arsim,
- ❖ Grantin specifik për shëndetësi,
- ❖ Projektionet e të hyrave vetanake nga komunat.

1.1 Granti i Përgjithshëm

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 284.68 milion euro. Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të

donatorëve, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale. Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2024 pritet të jenë 2,985.32 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 284.68 milion euro.

Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2024-2026 (mil. Euro)

Përshkrimi	Viti 2021 Rishikuar	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	1,921.80	2,037.10	2,676.30	2,985.32	3,194.65	3,400.29
Zbriten:						
Mbeshjetja buxhetore dhe grante	(15.00)	(10.50)	(10.50)	(18.00)	(10.50)	(10.50)
Tatimi në pronë	(30.00)	(41.00)	(44.59)	(49.34)	(50.74)	(53.37)
Grantet e percaktuara të donatorëve			(12.00)	(12.00)	(12.00)	(12.00)
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale	(48.00)	(46.90)	(54.00)	(56.18)	(58.99)	(61.94)
Të hyrat nga interesi	(3.00)	(3.40)	(3.10)	(3.00)	(2.69)	(2.69)
B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komunal	1,825.80	1,935.30	2,552.11	2,846.80	3,059.73	3,259.80
C. Granti i përgjithshëm për komuna (10%)	182.58	193.53	255.21	284.68	305.97	325.98

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë/e. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL:

1. numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%);
2. përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%);
3. numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%);
4. komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Tabela 2: Struktura e Grantit të Përgjithshëm për 2024-2026 sipas LFPL (mil. Euro)

Faktorët	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Granti i përgjithshëm	182.58	193.53	255.21	284.68	305.97	325.97
Shuma Fikse	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6
Popullsia (banorë)	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021
Buxheti: 89% e shumës agregate	159.2	169.0	223.9	250.1	269.1	286.9
Zona komunale (km ²)	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901
Buxheti: 6% e shumës agregate	10.74	11.39	15.09	16.86	18.14	19.34
Komunitetet pakicë në komunë	107,926	107,926	107,926	107,926	107,926	107,926
Buxheti: 3% e shumës agregate	5.4	5.7	7.5	8.4	9.1	9.7
Popullsia e komunave pakicë	62,031	62,031	62,031	62,031	62,031	62,031
Buxhti: 2% e shumës agregate	3.6	3.8	5.0	5.6	6.0	6.4

Tabela 3 në vijim paraqet shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm nëpër komuna sipas formulës të paraparë në LFPL.

Tabela 3: Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm nëpër komuna 2024-2026
Formula e ndarjes së Grantit të Përgjithshëm për vitin 2024-2026

Kriteret		Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Të hyrat Buxhetore (mil. €)		2,846.80	3,059.73	3,259.80
Granti i Përgjithshëm (10%)	10%	284,680,000	305,973,000	325,980,000
Shuma Fikse	140,000	3,636,657	3,636,657	3,636,657
Gjithsej		281,043,343	302,336,343	322,343,343
Popullsia	89%	250,128,575	269,079,345	286,885,575
Madhësia gjeografike	6%	16,862,601	18,140,181	19,340,601
Popullsia pakicë	3%	8,431,300	9,070,090	9,670,300
Komunat me popullsi pakicë	2%	5,620,867	6,046,727	6,446,867

Kriteret e ndarjes së Grantit të Përgjithshëm (sipas LFPL)																
Komuna	Popullsia		Madhësia Gjeografike		Popullsia Pakicë		Komunat me popullsi pakicë		Shuma Fikse (140,000 - 1€)	Shuma për popullsi 89%	Shuma për madhësi gjeografike (6%)	Shuma për popullsi pakicë në Komuna (3%)	Shuma për Komunat me popullsi pakicë (2%)	GP për vitin 2024	GP për vitin 2025	GP për vitin 2026
	Popullsia	89%	Madhësia Gjeografike	6%	Popullsia Pakicë në Komuna	3%	Komunat me popullsi pakicë	2%								
Hani i Elezit	9,403	0.53%	83	0.76%	44	0.04%	-	0.00%	130,597	1,321,310	128,597	3,437	-	1,583,941	1,694,053	1,797,514

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna përfshihet në kuadër të grantit të përgjithshëm të komunës. Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim para universitar dhe Shëndetësi primare financohen nga granti i përgjithshëm në komuna.

Po ashtu, nga granti i përgjithshëm do të plotësohen edhe grantet specifike për arsim dhe shëndetësi kur është e nevojshme.

Granti Specifik për Arsim Parauniversitar

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2024-2026. Grantin specifik për arsim para universitar për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 238.5 milion euro si në vijim:

o Paga dhe shtesa në shumë prej 223 milion euro,

o Mallra dhe shërbime në shumë prej 13.2 milion euro,

o Shpenzime kapitale në shumë prej 2.3 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit para fillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriteret:

a) Numri i ***nxënësve/nxënseve*** të regjistruar për vitin 2022/2023;

b) Raporti ***nxënës-mësimdhënës/e*** për arsimin fillor dhe të mesëm për ***nxënësit/nxënëset*** shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);

c) Raporti ***nxënës-mësimdhënës/e*** për arsimin fillor dhe të mesëm për ***nxënësit/nxënëset*** pakicë 1:14.2;

d) Raporti ***nxënës-mësimdhënës/e*** për arsimin parashkollor 1:12;

e) Raporti ***nxënës-mësimdhënës/e*** për arsimin e mesëm profesional për ***nxënësit/nxënëset*** shumicë 1:17.2, dhe për ***nxënësit/ nxënëset*** pakicë 1:11.5;

f) Raporti ***nxënës-mësimdhënës/e*** për zonat malore 1:14.2;

g) Kalkulimi për stafin ***mësimdhënës/e*** të gjuhës angleze për klasën I dhe II;

h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 ***nxënës/nxënëse*** 1 staf në arsimin para fillor dhe fillor;

- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 **nxënës/nxënëse** 1 staf në arsimin e mesëm;
- j) Kalkulimi për stafin **ndihmës/e** për 170 **nxënës/nxënëse** 1 staf (**pastrues/e**) si dhe 1 staf për shkollë (**roje**);
- k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
- l) Shërbimi profesional **Pedagogjik/e/Psikologjik/e**;
- m) **Koordinatorët/et** e cilësisë;
- n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për **nxënës/nxënëse** (23 euro për **nxënës/nxënëse** shumicë dhe 25 euro për **nxënës/nxënëse pakicë**) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për **nxënës/nxënëse**;
- p) **Asistent/e** për fëmijë me nevoja të veçanta;
- q) Praktika profesionale;
- r) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla);
- s) **Këshilltarë/e** të karrierës me bazë në shkollë klasa 6 deri 9;
- t) **Specialist/e** të IT-së.

Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 9,859 nxënës/nxënëse më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak. Numri i synuar për reduktim të 485 pozitave të lira (Tabela 5) ka të bëjë me mos plotësimin e tyre duke pas parasysh faktin që këto pozita jenë mbi formulën e financimit për arsimin parauniversitar. Po ashtu në rastet kur numri aktual është mbi numrin e lejuar sipas formulës së financimit, me rastin e pensionimit të stafit aktual nuk do të ketë punësim të ri me qëllim të arritjes së synimit për respektimin e numrit sipas formulës së financimit.

Tabela 5: Të dhënat statistikore për arsimin parauniversitar për vitin 2024

NR		KOMUNAT		TOTAL NUMRI I NXËNËSVE 2024		Personeli																																																	
						Numri i mësimdhënësve/eve në arsimin special		Numri i nënësve/nxënësë në arsimin special në pushim mjekësor dhe tël ehonisë		Numri i mësimdhënësve/eve parafillor		Numri i mësimdhënësve/eve në sh. parafillor në pushim mjekësor dhe tël ehonisë		Numri i mësimdhënësve/eve fillor		Numri i mësimdhënësve/eve në sh. fillorenë pushim mjekësor dhe tël ehonisë		Numri i mësimdhënësve/eve tësh. të mesme		Nr. i mësimdhënësve/eve në Qendren Korrektuesenë Lipjan/ SHMLP"Rudina"		Mësimdhënësit e sh.mesme në pushim mjekësor dhe tël ehonisë		Mësimdhënësit shitesëpër zonat malore		Numri i mësimdhënësve/eve të gjuhës angleze		Numri i kordinatorëve/eve të cilësisë		Asistent / e për fëmijët menevojat tëveçanta		Numri i edukatoreve/e (4-5)		TOTAL NUMRI I MESIMDHËNËSVE/EVE		Numri i personelit administrativ për çerdhe dhe sh. fillore		Numri i personelit administrativ për sh. të mesme		Shërbimi Profesional Pedagogjik/ Psikologji		Numri i personelit ndihmës për nxënës		Numri i specialisteve/e të IT-së		Numri i këshilltarëve/eve të karrierës me bazën shkollëkl 6 deri 9		GJITHSEJ NUMRI I MESIMDHËNËSVE/EVE, PERSONELIT ADMINISTR. DHE NDIHMËS 2024		Stafi i aprovuar me Ligj të Buxhetit 2023		Stafi aktual mars 2023		Reduktimi i synuar për vitin 2024	
GJITHSEJ		326,867		431		16		2,037		137		8,918		596		3,723		6		250		2,642		305		837		500		490		20,889		1,167		294		520		3,098		30		59		26,057		29,841				27,991		485	
8 Hani i Elezit		1,733		5		0.2		12		1		53		4		12		0		1		10		1		4		8		3		113		6		2		3		16.1		1.0		1.0		142		147		124		0			

Tabela 6: Shpërndarja e grantit specifik për arsimin parauniversitar për vitin 2024-2026

KOMUNAT	Paga dhe shtesa			Mallra dhe shërbime						Shpenzime kapitale	Gjithsej Granti specifik për arsim parauniversitar për vitin 2024	Gjithsej Granti specifik për arsim parauniversitar për vitin 2025	Gjithsej Granti specifik për arsim parauniversitar për vitin 2026
	Paga për stafin aktual	Paga për pozitat e lira	Gjithsej paga dhe shtesa	Mallrat dhe shërbimet për shkolla	Mallrat dhe shërbimet për nxënës	Praktika profesionale	Mallra dhe Shërbime për femijë (2 deri në 5 vjeç)	Kosto për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla)	Gjithsej mallra dhe shërbime				
Hani i Elezit	977,723	49,680	1,027,403	10,750	39,614	(543)	428	0	50,249	11,970	1,089,623	1,122,311.29	1,155,981

Granti Specifik për Shëndetësi Primare

Propozimi granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2024 do të jetë në shumë prej 81.96 milion euro, si në vijim:

- Granti bazë do të jetë në shume prej 76.5 milion euro, granti bazë është kalkuluar duke marre përbazë:
 - kategorinë paga dhe shtesa në sektorin e shëndetësisë në shume prej 62.3 milion euro,
 - koston për vizitë dhe shërbim në shume prej 14.2 milion euro.
- Politikat në vazhdimësi me kosto prej 5.4 milion euro të cilat janë:
 - Vizitat në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë (vizita x 10 euro) në shumë prej 3.4 milion euro,
 - Vizitat e kujdesit paliativ (vizitë x 20 euro) në shumë prej 2 milion euro.

Të dhënat statistikore për Shëndetësinë primare për vitin 2024-2026

Nr.	Komuna	Popullsia, Standardet për mjek dhe infermier dhe Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor																	
		Popullsia	Demografia						Standardet për mjek dhe infermier								Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor		
			Gjinia			Mosha		Numri i persona ve me nevoja të vecanta	Standardet 1 MF/ 2000 banorë	Standar det 01 Stomatolog/e 5000 banorë	Standar det 01 Farmacist / e në QK MF	Standar det 01 Biokimist/enë QKMF	Gjithsej Mjek/e	Infermiere/e Familjar	Infermier/e (për mjek/e specialist/e, stomatolog/e, laborator/e etj	Gjithsej (mjek/e dhe infermiere/e dhe farmacist/e)	Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF)	Qendër e Mjekësisë Familjare (QMF) 10,000 banorë	Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF)
			M	F	Femra të moshës riprodhuese 15-49 vjec	Numri i fëmijëve 0-14 vjec	Numri i personave të moshuar mbi 65 vjec												
8	Hani i El e zi t	9,403	4,836	4,567	1,824	2,778	560	73	5	2	1	1	9	10	7	26	1	0	1

Tabela 8: Granti specifik për Shëndetësi primare për vitin 2024-2026

Granti Bazë									Politikat në vazhdimësi						Granti Specifik për shëndetësi primare 2024	Granti Specifik për shëndetësi primare 2025	Granti Specifik për shëndetësi primare 2026
Komuna	Popullsia	Gjithesëj Paga dhe shtesa	Kostoja për vizit dhe shërbim				Gjithësej Granti Bazë për vitin 2024	Vizitat në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë			Kujdesi paliativ		Gjithsëj politikat në vazhdimësi				
			Numri i vizitave		Numri i shërbimeve			Popullsia që duhet të vizitohet, kriteret për gratë shtatzëna	Nr i rekomanduar i vizitave të bëra cdo vit	Kostoja e parashikuar për vizitat në shtëpi (10 euro)	Vizitat e kujdesit paliativ	Kosto për kujdesin paliativ (vizite x 20 euro)					
			2 vizita për kokë banori/e	2 euro për vizitë	2 shërbime për kokë banori/e	2 euro për shërbime											
Hani i Elezit	9,403	291,704	18,806	37,612	18,806	37,612	75,224	366,928	541	1,877	18,770	782	15,640	34,410	401,338	421,405	442,475

Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2024 dhe parashikimet 2025-2026

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2024 bazuar, në vlerësimet makro-fiskale, janë shumë prej 105.5 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale.

Në këtë projeksion sa i përket të hyrave tatimore janë marrë parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme sipas faturimit të tatimit në pronë dhe tokë (ngarkesat tatimore) ndërsa për të hyrat jo tatimore është marrë për bazë mesatarja e realizimit të të hyrave jo tatimore gjatë tri vitet e fundit dhe parashikimet e komunave mbi trendin e rritjes së të hyrave jo tatimore.

Tabela 12: Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2024-2026

Nr.	Komuna	Të hyrat tatimore						Të hyrat jo tatimore			Projeksionet për vitin 2024	Projeksionet për vitin 2025	Projeksionet për vitin 2026
		Tatimi në pronë 2024	Tatimi në tokë 2024	Tatimi në pronë 2025	Tatimi në tokë 2025	Tatimi në pronë 2026	Tatimi në tokë 2026	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026			
	Hani i Elezit	151,848	32,065	155,853	32,772	163,579	34,135	90,464	94,987	99,736	274,376	283,612	297,450

ANEKSI I

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse
Komuna Hani i Elezit

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2021	224	79	145	562,714	977,944
2022	224	76	148	644,482	1,111,601
2023	249	103	128	595,647	1,107,175
Planifikimi për 2024	249	119	130	816,800	1,225,200

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2024- Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore
Komuna Hani i Elezit

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel.	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
401-600					
600+					

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)
Komuna Hani i Elezit

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve gra	Numri i përfituesve burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2021	75,000	330	175	155	28,000	47,000
2022	80,000	340	180	160	24,500	54,000
2023	100,000	70	7,900	23,200	50,000	50,000
Planifikimi për 2024	113,000	350	175	175	56,500	56,500

Sqarim: Numri i përfituesve dhe shumat nuk janë definitive për vitin 2023 pasi që ende nuk është shpenzuar totalisht kategoria e Subvencioneve.

PJESA E DYTË

4. OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET E KOMUNËS PËR VITET 2024-2026

Objektivat e Komunës së Hanit të Elezit:

1. Zgjidhja e problemit të mungesës së ujit dhe menaxhimit të rrjetit në të gjitha vendbanimet,
2. Verifikimi dhe certifikimi i instrumenteve për matjen e pluhurit dhe gazrave të SharrCem-it,
3. Ndryshimi i lokacioneve ekzistuese të paisjeve për matjen e emitimit të gazrave,
4. Përdorimi i burimeve alternative të energjisë për SharrCem,
5. Gjelbërimi i sipërfaqeve të eksploatuara nga SharrCem,
6. Zvogëlimi i nivelit të zhurmës që prodhohet nga SharrCem,
7. Vlerësimi i vazhdueshëm i popullatës dhe **punëtorëve/eve** në SharrCem për prezencën eventuale të fibrave të azbestit në trupin e tyre,
8. Në bashkëpunim me autoritetet doganore do të zvoglohet koha e pritjes së kamionëve në kufi,
9. Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza,
10. Trajtimi i qenve endacakë,
11. Mbrojtja nga prerjet ilegale të pyjeve duke vendosur pikat statike të kontrollit,
12. Vendosja e kamerave të vëzhgimit si dhe pajisjeve tjera adekuate në të gjitha hyrje-daljet në pyje,
13. Hapja e zyrës për mbrojtje të **qytetarëve/eve** për adresim të problemeve dhe nga mospërmbushja e obligimeve kontraktuale,
14. Ndriçim i të gjitha rrugëve në qytet dhe vazhdim-përfundimi i ndriçimit të rrugëve në fshatra,
15. Rritje e hapësirave të gjelbëruara dhe atyre rekreative,
16. Aplikimi i projekteve të testuara të ndriçimit publik me baza solare,
17. Shenjëzim horizontal e vertikal në të gjitha rrugët e territorit të komunës,
18. Rritje e kapaciteteve për parandalimin dhe përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore,
19. Riorganizimi i ndërmarrjeve publike,

20. Krijimi i qendrës së alarmimit,
21. Vendosja e hidranteve në të gjithë zonat, përfshirë të gjitha fshatrat,
22. Kuadro të reja për **zjarrëfikësit/et**,
23. Implementimi i masave të sigurisë nëpër të gjitha objektet sidomos ato publike,
24. Vendosja e një partneriteti të ngushtë me mërgatën me qëllim të zhvillimit të projekteve komunale,
25. Subvencionimi i bizneseve me mjete monetare,
26. Promovimi i potencialeve që ka komuna me qëllim të nxitjes së investimeve,
27. Funkcionalizimi i zonës ekonomike dhe krijimi i zonave të reja,
28. Krijimi i plantacioneve të reja me pemë e perime,
29. Promovimi dhe subvencionimi i blegtorisë,
30. Krijimi i zyrës për zhvillim ekonomik,
31. Hartimi i Strategjisë për promovimin e potencialeve zhvillimore,
32. Organizimi i konferencave dhe punëtorive me fokus ekonominë,
33. Krijimi i lehtësirave për të bërit biznes,
34. Rritja e të hyrave vetanake,
35. Financim shtesë nga Qeveria, përveç Granteve Qeveritare,
36. Aplikimi digjital (web faqe) i kërkesave nga **qytetarët/et**,
37. Publikimi i të gjitha shpenzimeve komunale në formë të rregullt,
38. Asfaltimi i të gjitha rrugëve në qytet,
39. Kompletimi i infrastrukturës (ujësjelles dhe rrugë) në të gjitha fshatrat,
40. Ndërtimi i nënkalimeve-mbikalimeve,
41. Ndërtimi i fushave rekreative sportive,
42. Ndërtimi i parkingjeve,
43. Renovimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF),
44. Funkcionalizimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare (AMF) në fshatin Gorancë,
45. Konsolidimi i shërbimit të emergjencës dhe avancimi i tij në qendër të shërbimit të emergjencës,
46. Shtimi i vizitave mjekësore shtëpiake,
47. Rritja e shkallës së mbështetjes me furnizime ushqimore për familjet në nevojë,
48. Rritja e mbështetjes së organizatave të personave me nevoja të veçanta,

49. Rritja e kujdesit shëndetësor ndaj familjeve të personave me nevojë të veçantë,
50. Rregullimi dhe mirëmbajtja e sallave dhe fushave sportive në të gjitha shkollat,
51. Pajisje e shkollave me kabinete e laboratorë,
52. Hapja e drejtimeve profesionale në shkollën e mesme të lartë,
53. Krijimi i mundësive që Hani i Elezit të ketë një bibliotekë qendrore,
54. Instalimi i kamerave në të gjitha shkollat e komunës,
55. Digjitalizimi i mësimi dhe i bibliotekave shkollore,
56. Bashkëpunim në formë binjakëzimi me shkollë jashtë vendit, për këmbim të përvojave dhe metodave,
57. Rritje të numrit të bursave për *studentë/e*,
58. Ndërtimi i shkollës fillore në “Lagjen e Re”,
59. Rishikimi dhe finalizimi i Planit Zhvillimor Komunal,
60. Plan rregullues të hollësishme për zonat ku do të jetë e nevojshme,
61. Formimi dhe funksionalizimi i një zyre shërbyese vetëm për nevojat e urbanizmit,
62. Rritja e pjesëmarrjes së *qytetarëve/eve* në procesin e planifikimit hapësinor e buxhetor,
63. Trajtimi i objekteve të ndërtuara pa leje,
64. Subvencionimi i *fermerëve/eve* për ngritjen e serrave,
65. Funksionalizimi i një skene verore, ku do të organizoheshin koncerte e shfaqje tjera,
66. Ngritja e qendrave të reja rinore në fshatra,
67. Rritja e përkrahjes financiare e aktiviteteve sportive, kulturore e rinore,
68. Investimet në monumente të cilat rrezikojnë të shkatërrohen,
69. Organizimi i manifestimeve e takimeve të ndryshme kulturore, shoqërore e sportive gjatë periudhës së ardhjes së diasporës,
70. Promovimi i potencialit turistik që ka komuna jonë në malet përreth si Kodra e Staneve, Puset e Nikës, Pishat në Krevenik, Lumi Lepenc,
71. Përcaktimi i zonave turistike dhe arkeologjike të komunës,
72. Rivitalizimi i objekteve të trashëgimisë kulturore,
73. Hartimi i rregullores për sportin në Hanin e Elezit, e cila do përfshijë kushtet financiare të funksionimit të klubeve, pagesat e pagave të sportistëve dhe institucionalizimi si klube zyrtare apo të sponsorizuara nga bizneset lokale,
74. Krijimi i fondit për sportin bazuar në donacionet dhe sponsorimet e bizneseve,

75. Ndërtimi i qendrave inovatore për të rinjtë,
76. Formimi i ligës së futbollit dhe volejbollit në shkolla fillore dhe të mesme,
77. Ndërtimi i terreneve sportive në lagje të qytetit, si dhe në të gjitha fshatrat e komunës sonë.

Objektivat:

a)Shtimi i efikasitetit gjatë operacioneve

- Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit në shpenzimin e buxhetit komunal;
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve;
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve;
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur;
- Përzgjedhja e punëve me prioritet për realizim;
- Ruajtja e statistikave të ndara sipas gjinisë do të jetë obligim i secilës drejtorie.

b)Rritja e shpejtë e të hyrave

- Rritja e efikasitetit në inkasimin e të hyrave;
- Mundësia për implementim të tarifave të reja.

c)Kontrolli dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme;
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë;
- Përparësia nga blerja me shumicë;
- Planet për kursim nga shpenzimet- kontratë kornizë.

d)Zhvillimi i aftësive

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore;
- Përdorim i softuerëve të avancuar për shërbime;
- Profesionalizimi i shërbimeve

e)Sigurimi i disiplinës financiare

- Harmonizim me politikën financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet administrative;
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik përmes ueb-faqes komunale dhe mënyrave të tjera të komunikimit në mënyrë që të informohen të gjithë qytetarët;
- Analizat e vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve;

- Realizimi i buxhetit sipas planit të rrjedhës së parasë së gatshme (Keshi Plani);
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas programit SZHMB;
- Planifikimi dhe realizimi i investimeve kapitale sipas programit PIP;
- Respektimi i ligjit të buxhetit-mos hyrja e obligimeve pa mbulesë, zotim të mjeteve.

f) Ekonomia

- Zhvillimi i strategjisë komunale për promovim ekonomik;
- Krijimi i kushteve për donatorë të brendshëm dhe të jashtëm;
- Strategjia për zhvillimin rural të turizmit.

Programet

Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparencës

- Respektimi i procedurave të prokurimit;
- Evidenca e duhur financiare dhe procedurat e kontabilitetit;
- Koordinimet në mes departamenteve;
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat;
- Mbajtja e të dhënave të ndara sipas gjinisë për secilën drejtori;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave dhe përhapja e informatave;
- Informimi publik.

Përmirësimi i bazës së të hyrave komunale vetanake

- Rritja e performancës së arkëtimit të tarifave dhe taksave komunale;
- Regjistrimi i tatimpaguesëve të rinj për tatimin në pronë;
- Tarifa (Ngarkesa) të reja për shërbime të reja (tatimi në tokë);
- Çmime (ngarkesa) të ndryshme.

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat

- Zbatimi dhe respektimi i rregulloreve komunale;
- Kujdesi ndaj palëve në Qendrën për shërbim të **qytetarëve/eve**;
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës 2023;
- Përgatitja e Kornizës afatmesme të shpenzimeve 2023-2025;
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore komunale me **qytetar/e**;
- Shqyrtimi i përgjegjësisë dhe i obligimeve komunale;
- Menaxhimi i projekteve;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave;
- Monitorimi;
- Vlerësimi.

KORNIZA FISKALE KOMUNALE PËR VITET 2024– 2026

- Korniza fiskale komunale apo korniza e të hyrave komunale përfshinë pjesën e buxhetit komunal nga aspekti i parashikimit të të hyrave të përgjithshme komunale për sigurimin e mjeteve për financimin e shpenzimeve të komunës për periudhën e viteve 2024-2026.
- Projektionet në kornizën fiskale komunale për vitet 2024-2026, janë të bazuara në përputhshmëri të plotë me kufijtë buxhetor me **Qarkoren Buxhetore 2024/01** për Komunitet dhe me parashikimet e miratuara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026 të Qeverisë së Kosovës.
- Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale (politikës së të ardhurave si nga financimi i qeverisë, të hyrave vetanake komunale si dhe shpenzimeve).
- Për vitin fiskal 2024 parashikohet një buxhet në lartësi prej 3,349,278.00 € apo një rënie e lehtë prej 436.00 € apo për 1.30 % në raport me vitin 2023, kurse për vitin 2025 kemi një parashikim të buxhetit në lartësi prej 3,521,381.29 € apo një rritje prej 172,103.29 € ose 5.13% në raport me vitin 2024, si dhe për vitin 2026 vlerësohet një buxhet prej 3,693,420.00 € apo një rritje prej 172,038.71 € apo për 4.8% më i madh në raport me vitin 2025.
- Analizuar financimin sipas llojeve të Granteve Qeveritare, në periudhën vijuese 2024-2026, financimi nga **Granti i përgjithshëm (GP)**, për vitin buxhetor 2024, do të kemi në dispozicion shumë prej 1,583,941.00 € apo një rritje prej 152,396.00 € apo 10.6 % në krahasim me vitin 2023.
- Te **Granti Specifik i Arsimit**, i cili financim qeveritar ka si kriter kryesor numrin e nxënësëve, në vitin 2024 parashikohet të jetë në shumë prej 1,089,623.00 € ose një rritje prej 96,136.00 € ose 9.6 % në krahasim me vitin 2023.
- Te **Granti Specifik i Shëndetësisë**, i cili financim qeveritar është në shumë prej 401,338.00 € për vitin 2024, ku kemi një rritje në krahasim me vitin 2023 për 36,777.00 € apo 10.08%.
- Te **të hyrat vetanake komunale (THVK)** për vitin 2024, parashikohet të jenë në lartësi prej 274,376.00 € apo një rënie prej 285,745.00 € apo 51 % në krahasim me vitin 2023, ndërsa për vitin 2025 THVK parashikohen të jenë në lartësi prej 283,612.00 € apo një rritje prej 9,236.00 € apo prej 3.3 %, ndërkaq për vitin 2026 do të kemi një vlerësim prej 297,450.00 € apo një rritje 13,838.00 € apo prej 4.8% në krahasim me vitin 2025.

Perspektiva e Politikave Fiskale Komunale

Në hartimin e perspektivës së politikave fiskale komunale jemi bazuar në informatat dhe analizat e KASH-it 2024-2026, në të cilin dokument projeksionet makro-fiskale parashohin një përmirësim të konsiderueshëm në vjeljen e të hyrave vetanake komunale (THVK), në rritjen e efikasitetit të shpenzimeve të parashë publike, në zbatimin e kursimeve buxhetore, etj.

Financimi komunal nga të hyrat vetanake komunale për vitin 2024, të parashikuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026, bazohet në dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Të hyrat vetanake komunale për vitin 2024 për të gjitha OB-të dhe projeksionet për vitet 2025-2026, përfshijnë të hyrat e planifikuara të cilat janë aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 105,523.577.00 € për vitin 2024, kurse për vitin 2025 në shumë prej 109,734.756.00 €, respektivisht për vitin 2026 parashihen të hyra në shumë prej 115,386,494.00 €.

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2023 bazuar, në vlerësimet makro-fiskale, janë në shumë prej 105.5 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale.

Të hyrat e gjithëmbarshme buxhetore komunale për periudhën e viteve 2024-2026

Burimet e të hyrave	Buxheti 2022	Buxheti 2023	Planifikimi për vitin 2024	Vlerësimet 2025	Vlerësimet 2026
Granti i Përgjithshëm	857,832.00	1,431,545.00	1,583,941.00	1,694,053.00	1,797,514.00
Granti specifik i Arsimit	1,172,278.00	993,487.00	1,089,623.00	1,122,311.29	1,155,981.00
Granti specifik i Shëndetësisë	348,301.00	364,561.00	401,338.00	421,405.00	442,475.00
Të hyrat vetanake	381,347.00	560,121.00	274,376.00	283,612.00	297,450.00
Totali	2,759,758.00	3,349,714.00	3,349,278.00	3,521,381.29	3,693,420.00

Duke u bazuar në trendet makro-ekonomike dhe projeksionet e dhëna në nivel të vendit dhe bazës së të dhënave numerike në vlerësimet tona të hershme buxhetore për periudhën 2024-2026, buxheti i komunës do të shënoj trende të rritjes në shumë prej 364,279.00 € përveç vitit 2024 parashihet një rënie prej 436.00 €.

Në vitin 2024 do të kemi një rënie prej 1.30% ose për 436.00 € në raport me vitin 2023, kurse për vitin 2025 kemi një parashikim të buxhetit në lartësi prej 3,521,381.29 € apo një rritje prej 172,103.29 € ose 5.13 % në raport me vitin 2024, si dhe për vitin 2026 vlerësohet një buxhet prej 3,693,420.00 € apo një rritje prej 172,038.71 € apo për 4.8% më i madh në raport me vitin 2025.

Në vitin e parë buxhetor 2024 sipas këtyre parametrave, do të kemi këtë strukturë buxhetore të sigurimit të mjeteve dhe atë si vijon:

- ❖ nga Granti i Përgjithshëm me pjesëmarrje prej 1,583,941.00 € apo 47.29%,
- ❖ nga Granti Specifik i Arsimit me pjesëmarrje 1,089,623.00 apo 32.53%,
- ❖ nga Granti Specifik i Shëndetësisë me pjesëmarrje 401,338.00 apo 11.9%
- ❖ nga të Hyrat Vetanake Komunale me pjesëmarrje prej 274,376.00 € apo 8.19%,
- ❖ totali (Grantet + THVK) me pjesëmarrje prej 3,349,278.00 € apo 100.00 %.

Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal për vitet 2024-2026

Nr	Përshkrimi	Viti 2023	Vlerësimi 2024	Vlerësimi 2025	Vlerësimi 2026
A	B	C	D	E	F
1	TË HYRAT KOMUNALE TOTALE	3,349,714.00	3,349,278.00	3,521,381.29	3,693,420.00
1.1	TË HYRAT VETANAKE	560,121.00	274,376.00	283,612.00	297,450.00
1.1.1	Tatimi në pronë	105,326.00	151,848.00	155,853.00	163,579.00
1.1.2	Tatimi në tokë	117,411.00	32,065.00	32,772.00	34,135.00
1.1.3	Taksat Komunale	267,884.00	75,000.00	78,774.00	81,700.00
	<i>Licencat dhe lejet</i>	189,000.00	5,000.00	5,600.00	5,700.00
	<i>Certifikatat dhe dokumentet zyrtare</i>	6,884.00	8,000.00	8,500.00	8,600.00
	<i>Taksat e pajisjeve motorike</i>	30,000.00	9,000.00	9,200.00	9,300.00
	<i>Lejet per ndërtesa</i>	20,000.00	2,000.00	3,000.00	3,100.00
	<i>Taksat tjera komunale</i>	22,000.00	51,000.00	52,474.00	55,000.00
1.1.4	Ngarkesat Komunale	69,500.00	15,463.00	16,213.00	18,036.00
	<i>Të hyrat nga qiraja</i>	6,500.00	663.00	713.00	1,000.00
	<i>Bashkë-pagesat për arsim</i>	18,000.00	9,000.00	9,500.00	10,000.00
	<i>Bashkë-pagesat për shëndetësi</i>	10,000.00	5,800.00	6,000.00	7,036.00
	<i>Ngarkesat rregullatore</i>	17,000.00	-	-	-
	<i>Ngarkesat tjera komunale</i>	18,000.00	-	-	-
1.1.5	Të hyrat tjera (gjobat)	-	-	-	-
1.2	TRANSFERET QE VERITARE	2,789,593.00	3,074,902.00	3,237,769.29	3,395,970.00
1.2.1	Granti i përgjithshëm	1,431,545.00	1,583,941.00	1,694,053.00	1,797,514.00
1.2.2	Granti për Arsim	993,487.00	1,089,623.00	1,122,311.29	1,155,981.00
1.2.3	Granti për Shëndetësi	364,561.00	401,338.00	421,405.00	442,475.00

Të hyrat buxhetore komunale realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores për Taksa Komunale, Rregullorës së Tatimit në Pronën e Paluajtshme si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna është e autorizuar dhe ka të drejtë t'i inkasoj.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në Pronë dhe në tokë, si gjenerator kryesor i të hyrave vetanake komunale (THVK), e që këtë lloj të hyre komuna pas grumbullimit duhet ekskluzivisht të shpenzoj vetëm për qëllime të realizimit të projekteve kapitale si, në infrastrukturë rrugore, në ujësjellës, kanalizime dhe investime e tjera, që thënë ndryshe këto mjete pas inkasimit menjëherë i'u rikthehen qytetarëve/eve apo tatimpaguesëve/eve përmes formës së investimeve të destinuara për ngritjen e infrastrukturës komunale dhe mirëqenies sociale.

Të hyrat e komunës përbëhen kryesisht nga këto lloje të të hyrave:

- Tatimi në pronë;
- Tatimi në tokë;
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë biznesore;
- Taksat për leje të ndërtimit;
- Taksa për shfrytëzimin e pronës komunale;
- Taksa për regjistrimin e automjeteve motorike;
- Taksat administrative komunale (taksa për dokumentacionin lidhur me statusin shoqëror si,çertifikatat e lindjes, martesës, vdekjes, shtetësisë etj.);
- Bashkë-pagesat në arsim;
- Bashkë-pagesat në shëndetësi dhe
- Të hyra tjera.

Përveç të hyrave nga tatimi në pronë dhe në tokë kemi edhe taksat tjera komunale të cilat kontribuojnë dukshëm në krijimin e THVK, si: taksat për ushtrim të veprimtarisë së biznesit, taksa për regjistrimin e automjeteve motorike, taksat për shfrytëzimin e pronës komunale, taksa për lejet e ndërtimit, taksa për shfrytëzim të pronës publike, bashkëpagesat në arsim dhe shëndetësi, etj.

Duke u bazuar në të dhënat e prezentuara në tabelën e sipërme – Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal, THVK për vitin aktual buxhetor 2023 janë të planifikuara në shumë prej 560,121.00 €, ndërsa për vitet vijuese 2024-2026, përkatësisht në vitin e parë të planifikimit afatmesëm 2024, parashikohen që THVK të jenë në masë prej 274,376.00 € ose një rënie prej 285,745.00 € apo 51 %, në raport me vitin 2023, pastaj në vitin 2025 është shuma prej 283,612.00 € ose një rritje prej 9,236.00 € apo prej 3.3 % në raport me vitin 2024 dhe në vitin e tretë 2026 vlerësohet të jetë shuma prej 297.450.00 € ose një rritje prej 13,838.00 € apo prej

4.8%, në krahasim me vitin 2025. Mbështetur në të dhënat e pasqyruara në tabelarë dhe nga e gjithë kjo që u potencua, mund të konstatohet se përmbushja e të hyrave të përgjithshme buxhetore komunale për periudhën e ardhshme afatmesme 2024-2026, krahas varshmërisë së mëtejme që do të kemi nga alokimet e Granteve Qeveritare, gjithësesi do të jemi të varur edhe nga shkalla e realizimit të të hyrave komunale, e që këto të fundit kanë ndikim edhe në shkallën e ekzekutimit të kategorisë së shpenzimeve investime kapitale, të cilat do të financohen edhe nga ky burim i të hyrave.

KORNIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE

Shpenzimet buxhetore sipas programeve dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, në KABK për 2024-2026, janë të përfshira projeksionet orientuese sipas programeve dhe nënprogrameve buxhetore mbi bazën e ndarjës buxhetore në pesë (5) kategori kryesore të shpenzimeve për tre vitet e ardhshme të shpenzimeve të përgjithshme të komunës.

Këto projeksione dhe vlerësime të shpenzimeve buxhetore për vitet 2024-2026, janë të bazuara në politikat dhe prioritetet e përcaktuara më parë nga programet buxhetore dhe konsolidimi i tyre në nivel të organizatës buxhetore të komunës.

Për vitet 2024-2026, shpenzimet e përgjithshme operative buxhetore do të përqëndrohen para se gjithash në mbulimin e shpenzimeve nga ushtrimi i kompetencave komunale dhe funksionimin sa më efikas të tre (3) sektorëve publik si: të administratës komunale, arsimit, si dhe të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

Ndërsa, te shpenzimet kapitale bazuar në kërkesat e parashtruara nga programet buxhetore, do të bëhen përpjekjet maksimale në sigurimin e mjeteve buxhetore për vitet 2024-2026, duke u krijuar një konsum investiv me një pjesëmarrje në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore të komunës.

Në sferën e realizimit të projekteve kapitale 2024-2026, rëndësi e posaçme do t'i kushtohet edhe bashkëpunimit me donatorët, qoftë financimit nga Ministritë e Linjës, pastaj financimit të jashtëm përmes fondeve IPA (Instrumenti për Asistencë Para - Anëtarësimi) për shtimin e masës së mjeteve për investime kapitale, për bashkëfinancim të projekteve investive publike (PIP).

Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2023

Nën-program	Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total 2023
16035	Zyra e Kryetarit	9	78,012	30,000		47,500		154,952
16935	Zyra e Kuvendit Komunal	0	61,719	15,000				76,719
16335	Administrata dhe Personeli	16	93,130	75,000	60,000			223,463
17535	Buxheti dhe Financat	8	54,601	5,000				59,601
18444	Shërbimet Publike dhe Emergjencia	10	66,389	80,000		15,000	75,000	236,389
19675	Zyra Komunale për Komunitete	1	6,327	500				6,857
47115	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	5	28,938	3,500		11,500		49,136
48035	Zhvillimi Ekonomik	3	21,544	3,000				24,544
66480	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	8	56,277	20,959			790,392	867,628
730	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	34	266,145	80,500	14,500	-	30,000	403,801
73044	<i>Administrata e shëndetësisë</i>	2	16,084	500				16,584
75050	<i>Shërbimet e shëndetësisë primare</i>	32	250,061	80,000	14,500		30,000	387,217
75671	Shërbimet sociale	3	19,728	3,000	1,000	-	-	23,728
920	Arsimi dhe Shkenca	152	950,013	148,541	21,000	26,000	90,000	1,222,897
92175	<i>Administrata e arsimit</i>	5	32,901	32,901		26,000	90,000	202,934
92890	<i>Arsimi parashkollor dhe çerdhet</i>	13	68,059	695,699	3,000			81,309
94020	<i>Arsimi fillor</i>	111	682,477	78,413	14,500			775,390
95220	<i>Arsimi i mesëm</i>	23	151,886	7,878	3,500			163,264
	TOTALI	249	1,702,823	465,000	96,500	100,000	985,392	3,349,715

Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2024

Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe shtesat	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	9	94,000	40,000	-	55,000	-	189,000
Zyra e Kuvendit Komunal	0	135,000	15,000	-	-	-	150,000
Administrata dhe Personeli	15	100,000	85,000	52,000	-	-	237,000
Buxheti dhe Financat	8	65,000	2000	-	-	-	67,000
Shërbimet Publike dhe Emergjenca	10	75,000	105,000	-	16,000	100,000	296,000
Zyra Komunale për Komunitete	1	7,000	500	-	-	-	7,500
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	6	34,000	2,000	-	16,000	-	52,000
Zhvillimi Ekonomik	3	27,000	9,500	-	-	-	36,500
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	8	68,000	20,000	-	-	411,278	499,278
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	39	352,000	75,500	14,500	-	5,000	447,000
Administrata e shëndetësisë	2	22,000	500	-	-	-	22,500
Shërbimet e shëndetësisë primare	37	330,000	75,000	14,500	-	5,000	424,500
Shërbimet sociale	3	24,000	3,000	-	-	-	27,000
Arsimi dhe Shkenca	147	1,061,000	167,000	27,000	26,000	60,000	1,341,000
Administrata e arsimit	5	41,000	41,000	52,000	26,000	60,000	179,000
Arsimi parafill. dhe çerdhet	13	85,000	25,000	3,000	-	-	113,000
Arsimi fillor	106	770,000	80,000	20,000	-	-	870,000
Arsimi i mesëm	23	165,000	10,000	4,000	-	-	179,000
TOTALI	249	2,042,000	524,500	93,500	113,000	576,278	3,349,278
TOTALI (%)	-	61%	16%	2.8%	3.3%	17%	100%

Financimi i investimeve kapitale komunale 2024-2026

Nr	Përshkrimi	Planifikimi 2024	Vlerësimi 2025	Vlerësimi 2026	Shpenzime totale 2024-2026
	Hani i Elezit - 659	576,278.00	725,000.00	735,000.00	2,036,278.00
	SHPENZIMET KAPITALE TOTALE	576,278.00	725,000.00	735,000.00	2,036,278.00
180	Shërbimet publike dhe emergjenca	65,000.00	80,000.00	80,000.00	225,000.00
18444	Parandalimi dhe inspektimi i zjarreve	65,000.00	80,000.00	80,000.00	225,000.00
1	Rregullimi i kanalit të hapur në fshatin Paldenicë	10,000.00	20,000.00	15,000.00	45,000.00
2	Rregullimi i krojeve publike në Han të Elezit dhe në fshatrat: Dromjak, Dimcë, Paldenicë, Pustenik dhe Rezhancë	10,000.00	10,000.00	10,000.00	30,000.00
3	Ndriçimi publik në fshatrat: Pustenik, Dimcë, Gorancë, Krivenik, Seçishtë, Rezhancë, Paldenicë, Dermjak	10,000.00	20,000.00	15,000.00	45,000.00
4	Riparimi i rrugëve dhe trotuareve në Han të Elezit dhe në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Rezhancë, Krivenik	5,000.00	10,000.00	15,000.00	30,000.00
5	Shtimi i kapaciteteve të ujit në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit	30,000.00	20,000.00	25,000.00	75,000.00
480	Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik	18,000.00	20000	25,000.00	63,000.00
48035	Zhvillimi Ekonomik	18,000.00	20000	25,000.00	63,000.00
6	Shenjëzimi i pikave turistike në Han të Elezit dhe në fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë	8,000.00	10,000.00	15,000.00	33,000.00
7	Rregullimi i shtigeve për ecje përreth projit Dimcë-Dermjak	10,000.00	10,000.00	10,000.00	30,000.00
660	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	333,278.00	505,000.00	510,000.00	1,348,278.00
66480	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni	333,278.00	505,000.00	510,000.00	1,348,278.00
8	Mjete të lira për bashkëinvestime	20,000.00	20,000.00	25,000.00	65,000.00
9	Asfaltimi i rrugës Gorancë-Krivenik	10,000.00	-	-	10,000.00
10	Rregullimi i varrezave të qytetit	10,000.00	15,000.00	10,000.00	35,000.00
11	Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit në Rr. Isa Berisha dhe zonat rurale në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Krivenik, Dimcë	70,000.00	50,000.00	60,000.00	180,000.00
12	Rregullimi i prrockave dhe i kanalizimeve atmosferike në fshatrat: Paldenicë, Rezhancë dhe Seçishtë	15,000.00	20,000.00	15,000.00	50,000.00
13	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe në fshatrat: Paldenicë, Dermjak, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë	19,000.00	15,000.00	10,000.00	44,000.00
14	Ndërtimi i mbikalimeve në Rr. Martirët Bushi dhe Rr. Lepenci	30,000.00	50,000.00	60,000.00	140,000.00
15	Ndërtimi i parkut te rruga Lepenci	5,000.00	-	-	5,000.00
16	Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në Han të Elezit në Rr. Adem Jashari, Udha e Shkronjave, Driton Loku, Paldenicë	7,278.00	10,000.00	5,000.00	22,278.00

17	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe në fshatrat: Paldenicë, Dermjak, Pustënik, Seëishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë	8,000.00	10,000.00	15,000.00	33,000.00
18	Asfaltimi i rrugës Ekzodi 99 - Hani i Elezit	10,000.00	60,000.00	-	70,000.00
19	Asfaltimi i rrugës transit në fshatin Gorancë	-	100,000.00	150,000.00	250,000.00
20	Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seëishtë, Dimcë, Pustënik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik	49,000.00	60,000.00	60,000.00	169,000.00
21	Ndërtimi (Rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pustënik, Seëishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik	30,000.00	50,000.00	50,000.00	130,000.00
22	Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimcës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri, Stadiumi i qytetit - Suad Brava - Shpronësim	15,000.00	20,000.00	25,000.00	60,000.00
23	Ndërtimi i parkut në fshatin Paldenicë	20,000.00	5,000.00	-	25,000.00
24	Rregullimi i hapësirave publike (me kubëza betoni dhe gjelbërim) ne rr. Dëshmorët e Kombit, Isa Berisha në Han të Elezit dhe rr. Gafurr Loku fsh. Paldenicë	15,000.00	20,000.00	25,000.00	60,000.00
730	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	-	10,000.00	15,000.00	25,000.00
75050	Shërbimet e shëndetësisë primare	-	10,000.00	15,000.00	25,000.00
25	Rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së		10,000.00	15,000.00	25,000.00
920	Arsimi dhe Shkenca	160,000.00	110,000.00	105,000.00	375,000.00
92175	Administrata	160,000.00	110,000.00	105,000.00	375,000.00
26	Ndërtimi dhe rregullimi i këndeve të lojërave në Han të Elezit dhe fshatrat Gorancë, Paldenicë, Seëishtë	25,000.00	10,000.00	5,000.00	40,000.00
27	Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML - Dardania, SHFMU - Ilaz Thaëi, SHFMU - Kështjella e Diturisë dhe SHMFU - Veli Ballazhi	65,000.00	25,000.00	20,000.00	110,000.00
28	Ndërtimi i objektit të SHFMU në Lagjen e Re	60,000.00	60,000.00	70,000.00	190,000.00
29	Restaurimi i objekteve me trashëgimi kulturore	10,000.00	15,000.00	10,000.00	35,000.00

PJESA E TRETË

DEKLARATA PËR MISIONIN DHE PERFORMANCËN SIPAS DREJTORIVE

ZYRA E KRYETARIT

Deklarata e Misionit:

Kryetari i Komunës, përfaqëson Komunën dhe vepron në emër të saj, udhëheq ekzekutivin e Komunës dhe administratën dhe mbikqyrë administrimin financiar të komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e komunës; emëron dhe shkarkon **drejtorët/et** e drejtorive; propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës; propozon zhvillimin komunal, planet rregullative e investuese, propozon buxhetin komunal vjetor për miratim në Kuvendin e komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko - financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës; si dhe ndërmerr aktivitetet e tjera që i caktohen me Statut, Rregullore Komunale apo akte të tjera ligjore dhe nën ligjore të cilat janë në fuqi.

Deklarata e Vizionit:

Zhvillimi lokal ekonomik; planifikim urban e rural; shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimit; mbrojtje e mjedisit lokal; ofrimi i shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale; përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale; ofrimin sa më të mirë të arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, ofrimin e përkujdesit primar publik shëndetësor; ofrimin e mirëqenies sociale, përfshirë rritjen e nivelit të barazisë gjinore në të gjitha fushat, ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapsirës publike; turizmin, aktivitetet kulturore dhe të lira etj.

Deklarata e Qëllimit:

Qëllimi primar është që të gjitha kompetencat e komunës të rregulluara me Ligjin për Vetqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës të zbatohen në përpikëmeri në mënyrë që misioni i Komunës të shënoj shkallën sa më të lartë të performancës duke i realizuar me sukses qëllimet strategjike komunale.

Performancë:

Numri i të punësuarve/ave	9	9	9
Sipas gjinisë (femra-meshkuj)	3 6	3 6	3 6

	2024	2025	2026
Kuantitative			
Përgatitja e të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit komunal, në sferën e legjislacionit të nivelit të qeverisjes lokale (nxjerrja e rregulloreve, vendimeve, udhëzimeve) që kanë të bëjnë me një qeverisje sa më të mirë të të gjitha drejtorive të Komunës dhe gjithnjë në shërbim të gjithë qytetarëve/eve të Komunës.	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor.	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor.	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor.

Kualitative	2024	2025	2026
1.Mbledhjet e rregullta me drejtorët/et e drejtorive;	48	48	48
2.Mbledhjet e rregullta me KKSBB-në;	12	12	12
3.Mbledhjet e rregullta me administratorët/et e fshatrave dhe lagjeve të Komunës së Hanit të Elezit.	4	4	4

Informata mbi udhëheqësin:

Mehmet Ballazhi , Kryetar i Komunës

ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL

Deklarata e Misionit:

Kuvendi i Komunës është organ më i lartë legjislativ i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga **qytetarët/et** në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

Kuvendi i Komunës mund të miratojë aktet dhe të ndërmerr masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre e që vlejnë brenda territorit të Komunës dhe në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, dhe ato: Statutin e Komunës; rregullorën e punës; rregulloret komunale; dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionimin e Komunës.

Deklarata e Vizionit:

Zhvillimi lokal ekonomik, planifikimi urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, afirmimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor, ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale, përfshirje ngritjen e nivelit të barazisë gjinore në komunë, turizmin, aktivitetet kulturore dhe të lira.

Performancë:

	2024	2025	2026
Kuantitative			
1. Mbledhje të Rregullta të Kuvendit,	12	12	12
2. Mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa,	12	12	12
3. Mbledhje të Komitetit për Komunitete,	11	11	11
4. Debate Publike,	2	2	2
5. Lëndë të pranuar nga Ekzekutivi.	65	65	70
	2024	2025	2026

Kualitative			
1. Punët dhe detyrat e Shërbimit të Kuvendit kryhen nga dy (02) <i>punëtorë/e</i>, nga sekretari i kuvendit dhe <i>asistenti/ja i/e</i> Kuvendit; 2. Përbërja e Kuvendit është 15 <i>anëtarë/e</i>; prej tyre 7 janë të gjinisë femërore dhe 8 janë të gjinisë mashkullore. 3. Kuvendi i ka të formuara të gjitha komitetet obligative sipas LVL dhe Statutit të Komunës.			

Informata mbi udhëheqësin:

Florim Shkreta, Kryesues i Kuvendit të Komunës

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Deklarata e Misionit: Udhëheq dhe menaxhon me të gjitha çështjet administrative- teknike të drejtorisë dhe ato të SHCK-së që bien në këtë kompetencë, udhëheq me librat amë të gjendjes civile, lëshon certifikata të gjendjes civile, sjell aktvendime për regjistrime të më vonshme, korrigjime-ndryshime të emrit apo mbiemrit personal, harton aktet normative që bien në kompetencë të drejtorisë, udhëheq punën e arkivit komunal, qendrën për shërbim të **qytetarëve/eve**, sektorin teknik dhe të mirëmbajtjes, angazhohet dhe përcjellë punën e bashkpunimit të Komunës me vendbanimet dhe fshatrat si dhe punë tjera që bien në kompetencë të drejtorisë. Përmirëson nivelin e barazisë gjinore brenda Administratës së Komunës.

Deklarata e Vizionit: Administrata siguron të gjitha shërbimet administrative për Kryetarin dhe Kuvendin , procedurat e menaxhimit të stafit të shërbimit civil , gjithashtu menaxhon me stafin dhe buxhetin e kësaj drejtorie.

Deklarata e Qëllimit: Menaxhimi dhe ngritja e nivelit të lartë në Administratën Komunale, si dhe ngritja e kapaciteteve dhe shërbimeve më cilësore për **qytetarët/et** .

Performancë:

Numri i të punësuarve/ave	15		15		15	
Sipas gjinisë (femra-meshkuj)	2	13	2	13	2	13

	2024	2025	2026
Kuantitative			
Realizimi i të gjitha detyrave dhe objektivave që rrjedhin nga Statuti i Komunës, aktet tjera normative Komunale, ligjet, udhëzimet e organeve më të larta, rritja e vëllimit të punës në të gjitha sektorët dhe njësitë varësisht nga situata dhe nevoja e punës së shtuar sipas sezonave, nevojave apo ndryshimet eventuale në programe dhe kompetencat eventuale që mund t'i barten drejtorisë dhe sektorëve të saj. Të gjitha këto kërkojnë edhe përcjelljen me koston e shpenzimeve buxhetore .	Gjatë gjithë kohës	Gjatë gjithë kohës	Gjatë gjithë kohës
Kualitative	2024	2025	2026
Puna rreth certifikimit do të bëhet sipas programit unik të Kosovës, ku do të kemi një përmisim të kualitetit në shërbimet e karakterit civil	100%	100%	100%

Informata mbi udhëheqësin:

Natyra Kalisi, Drejtore e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Deklarata e Misionit: Bën menaxhimin e buxhetit dhe financave të Komunës, i siguron drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit, menaxhimin e shpenzimeve dhe i informon ***drejtorët/et komunal/e*** me aktivitetet e ndërlidhura me buxhetin e Komunës.

Deklarata e Vizionit: Përgatit rregulloret për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvend lidhur me menaxhimin e financave komunale, përgatitjen dhe prezentimin e buxhetit, kordinimin e punëve dhe aktivitetëve të drejtorisë, këshillon ***zyrtarët/et*** komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin.

Deklarata e Qëllimit: Përgatitja dhe harmonizimi i akteve ligjore dhe parakushteve e tjera për shtimin e efikasitetit në realizimin e të hyrave buxhetore.

Performancë:

Numri i të <i>punësuarve/ave</i>	8		8		8	
Sipas gjinisë (femra-meshkuj)	2	6	2	6	2	6

Kuantitative	2024	2025	2026
1. Përgatitja e raporteve buxhetore mbi të hyrat;	14	14	14
2. Përgatitja e raporteve buxhetore mbi shpenzimet;	14	14	14
3. Rishikim, rialokim dhe transfere buxhetore;	2	2	2
4. Zotime në sistemin e SIMFK-së (Frebalance);	1,300	1,330	1,370
5. Fatura tatimore mbi tatimin në pronë;	2,900	2,926	2,950
6. Kërkesa dhe ankesa rreth matjeve të pronave;	100	105	120
7. Lëndë të ndryshme me kërkesa;	150	160	170
8. Raportet e punës së drejtorisë dhe stafit;	2	2	2
9. Programi i punës së drejtorisë dhe stafit;	2	2	2
10. Çertifikime, aprovime dhe shpenzime të UZP-ve.	1,300	1,330	1,370
11. Integrimi i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator në KAB çdo vit.	1	1	1

Kualitative	2024	2025	2026
1.Të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë do të shpenzohen në realizimin e projekteve kapitale. 2. Menaxhimi me eficient i buxhetit dhe ekzekutimi i tij sipas dinamikës së planifikuar të rrjedhjes së parasë së gatshme.	100%	100%	100%

Informata mbi udhëheqësin:

Lindita Ballazhi, Drejtore e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Deklarata e Misionit:

- 1.Mbikëqyr dhe bashkëpunon me kompanitë shërbyese të Komunës, të higjienës dhe furnizimit me ujë;
- 2.Menaxhon dhe mirëmban të gjitha sheshet publike që i përkasin Komunës si dhe përkujdesjen për mirëmbajtjen e varrezave të Dëshmorëve;
- 3.Bashkëpunon me Institucionet, Organizatat Joqeveritare dhe të gjithë mekanizmat tjerë në raste të fatkeqësive elementare;
- 4.Menaxhon, organizon dhe administron me sektorët dhe shërbimet në kuadër të saj sipas instruksioneve administrative e të direktivave operative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionet dhe përgjegjësitë e DSHPE-së.

Deklarata e Qëllimit: Menaxhim dhe organizimi i situatave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, menaxhimi i mbeturinave dhe furnizim me ujë të pijshëm, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e rrugëve lokale në të gjitha vendbanimet gjatë sezonit veror-dimëror, mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik me kompanitë e kontraktuara, etj.

Deklarata e Vizionit: realizimi i suksesshëm i planit për parandalimin e emergjencave, reagimin e shpejt dhe të suksesshëm ndaj emergjencave, intervenime të suksesshme të shërbimit të zjarrfikësve/eve dhe shpëtimit, rritjen e performancës në shërbimin e zjarrfikësve/eve dhe shpëtimit, mirëmbajtja e pastërtisë së qytetit, ndriçimi elektrik i qytetit dhe i tërë zonës urbane, si dhe menaxhimin rrjetit të ujësjellësit duke bashkëpunuar me njësinë e Bifurkacionit, kanalizimit dhe mbeturinave duke bashkëpunuar ngushtë me kompaninë lokale të mbeturinave.

Performancë:

Numri i të <i>punësuarve/ave</i>	9		9		9	
Sipas gjinisë (femra-meshkuj)	0	9	0	9	0	9

Kuantitative	2024	2025	2026
1. Përgatitja e raportit vjetor të DSHPE-së dhe Emergjencës.	12	12	12
2. Do të alarmohen <i>qytetarët/et</i> për shkallën rrezikshmërisë në raste fatkeqësie.			
Kualitative	2022	2023	2024
1. Shërbime të drejta ndaj <i>qytetarëve/eve</i> .	100%	100%	100%
2. Menaxhimi i ujës-jellësve sipas dinamikës së planifikuar.			

Informata mbi udhëheqësin:

Arsim Dernjani, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Deklarata e Misionit: Siguron zbatimin e ligjeve dhe vendimeve të tjera të aplikueshme, bën përgatitjen dhe hartimin e akteve të përgjithshme normative të drejtorisë, përgatitë Planin Strategjik të Zhvillimit të Bujqësisë, koordinon dhe kontrollon të gjitha sferat që kanë të bëjnë me bujqësi.

Deklarata e Qëllimit: Menaxhimi dhe zbatimi më efikas i politikave bujqësore si dhe mbrojtja e *prodhuesëve/eve vendor/e*, mbikqyrja e pyjeve dhe zbatimi masave disiplinore kundër *prerësve/eve ilegal/e* të pyllit. Mbështetja aktive e grave që merren me bujqësi.

Deklarata e Vizionit: Përgatit dhe harton: propozim vendime, aktvendime, konkluzë, urdhëresa, procesverbale, kontrata, vërtetime, lajmërime dhe shkresa të tjera që kanë të bëjnë me

veprimtarinë e drejtorisë. Sigurohet që të rritet niveli i barazisë gjinore në fushën e bujqësisë.

Performancë:

Numri i të <i>punësuarve/ave</i>	6		6		6	
Sipas gjinisë (femra-meshkuj)	0	6	0	6	0	6

	2024	2025	2026
Kuantitative			
1.Ruajtja e tokave bujqësore, 2.Ruajtja e pyjeve publike, 3.Kërkesa për ndërrim destinimi të tokave, 4.Kërkesa për prerjen e pyjeve private, 5.Kërkesa për subvencione.			
Kualitative	2024	2025	2026
1.Kërkesa për ndërrim destinimi të tokave,	20	30	30
2.Kërkesa për prerjen e pyjeve private,	70	80	100
3.Kërkesa për subvencione.	100	120	120

Informata mbi udhëheqësin:

Abdurraman Bushi, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

Deklarata e Misionit: Krijimi i sektorit për planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Deklarata e Vizionit: Caktimi i prioriteteve për investim në Komunë dhe mbajtja e evidencave statistikore për zhvillim ekonomik.

Deklarata e Qëllimit: Dhënia e informatave profesionale dhe raporteve për Drejtorinë dhe institucionet e Komunës.

Performancë:

Numri i të <i>punësuarve/ave</i>	3	3	3
Sipas gjinisë (femra-meshkuj)	1 2	1 2	1 2

	2024	2025	2026
Kuantitative			
1.Caktimi i prioriteteve; 2.Mbajtja e evidencave; 3.Hartimi i programeve; 4.Krijimi i një ambienti të volitshëm për zhvillimin e NVM-ve dhe biznesit; 5.Dhënia e këshillave; 6.Bashkëpunimi me Ministrinë; 7.Bashkëveprimi me ndërkombëtarët; 8.Dhënia e informatave profesionale; 9.Koordinimi i punëve me OJQ; 10.Kryen punë tjera nga lëmia e zhvillimit ekonomik.	10	10	10

	2024	2025	2026
Kualitative			
Strategjia e zhvillimit socialo-ekonomik në bashkërenditje me planin zhvillimor komunal dhe planin zhvillimor urban.	100%	100%	100%

Informata mbi udhëheqësin:

Majlinda Kaloshi, Drejtore e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm

DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTËR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Deklarata e Misionit: Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të *aplikuesve/eve* dhe zgjidhja e tyre konformë ligjeve në fuqi dhe vendimeve të Komunës, ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe kualitative për *qytetarët/et*, përgatitja e raporteve dhe planeve të punës për drejtorinë.

Deklarata e Qëllimit: Përmes implementimit PZHK-së, PZHU-së, të PRRU-së dhe Hartave zonale të ndërtojmë Komunën, të ndërtojmë kadastrin, të mbrojmë mjedisin si dhe të rrisim të hyrat buxhetore Komunale. Inkurajim dhe mbështetje e grave për të regjistruar pronën.

Deklarata e Vizionit: Hartimi i hartave zonale dhe rregulloreve për gjithë territorin e Komunës, legalizimi i objekteve pa leje sipas ligjit të legalizimit, rindërtimi i kadastrit, krijimi i kadastrit të banesave, mbrojtja e mjedisit, përgatitja e materialeve për KPF dhe Kuvend, koordinimi dhe menaxhimi i punëve në drejtori.

Performancë:

	Numri i të <i>punësuarve/ave</i>	8	8	8
	Sipas gjinisë (femra-meshkuj)	2 6	2 6	2 6

	2024	2025	2026
Kuantitative			
1. Trajtimi i kërkesave urbanistike, 2. Trajtimi i kërkesave të kadastrit, 3. Ndarja e kërkesave të kadastrit dhe urbanistike.	Gjate tërë vitit	Gjate tërë vitit	Gjate tërë vitit
	2024	2025	2026
Kualitative			
1. Trajtimi i kërkesave urbanistike, 2. Trajtimi i kërkesave të kadastrit, 3. Ndarja e kërkesave të kadastrit dhe urbanistike.	100%	100%	100%

Informata mbi udhëheqësin:

Nexhmedin Daci, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Deklarata e Misionit: DSHMS siguron zbatimin e kujdesit parësor shëndetësor në ofrimin e shërbimeve shëndetësore nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare duke përfshirë promovimin dhe edukimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershem/diagnostifikimin, mjekimin/kujdesin dhe rehabilitimin e të ***lënduarit/at, të sëmurët/at*** me sëmundje akute dhe kronike, shëndetin oral, furnizimin me barna, kujdesin antenatal, kujdesin posnatal, planifikimin familjar, kujdesin paliativ, ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit, ofrimin e shërbimeve cilësore të sigurta, me qasje të lehtë, të barabartë për të gjithë ***qytetarët/et***.

Deklarata e Qëllimit: Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së ***qytetarëve/eve***. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, përmirësimi i ofrimit të shëndetësisë mobile për një komunitet të shëndetshëm.

Deklarata e Vizionit: KPSH kujdeset për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta, të ndërtuara mbi parimin e mjekësisë primare, të drejtuara nga nevojat dhe kërkesat e individëve, familjeve dhe bashkësisë me synim të promovimit dhe edukimit shëndetësor, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore ndaj secilit ***qytetarë/e***.

Performancë:

	Numri i të <i>punësuarve/ave</i>	34		34		34	
	Sipas gjinisë (femra-meshkuj)	19	12	19	12	19	12
Kuantitative		2024		2025		2026	
1. Promovim shëndetësor; 2. Edukim shëndetësor; 3. Diagnostifikim i sëmundjeve; 4. Shërbimi diagnostiko (LAB-RTG); 5. Vaksinim; 4. Trajtim i sëmundjeve; 5. Kujdesi paliativ; 6. Planifikim familjar –Klasa për nëna dhe fëmijë; 7. Programi për nëna dhe fëmijë; 8. Sistemi informativ shëndetësor (SISH); 9. Infrastruktura (objekti).		Tërë vitin		Tërë vitin		Tërë vitin	
Kualitative		2024		2025		2026	
1. Planifikimi, 2. SWOT Analiza- Analiza kërkimore, 3. Auditi shëndetësor, 4. Hulumtimet.		Niveli i kualitetit varet nga përgaditja profesioanle e stafit		Niveli i kualitetit varet nga përgaditja profesioanle e stafit		Niveli i kualitetit varet nga përgaditja profesioanle e stafit	

Informata mbi udhëheqësin:

Kimete Kuka Hasallari, Drejtore e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Deklarata e Misionit: QPS-së siguron ofrimin e përkujdesit për rastet sociale si dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për të gjithë *qytetarët/et* brenda territorit të Komunës.

Deklarata e Qëllimit: Arritja e rezultateve më të larta në ofrimin e shërbimeve dhe përkujdesje për të gjithë *qytetarët/et*.

Deklarata e Vizionit: QPS-së kujdeset që *banorëve/eve* brenda territorit të Komunës t’iu ofroj: përkujdes dhe mirëqenie sociale, këshillime gjithëpërfshirëse dhe efikase, zbatim i rregulloreve, identifikim të familjeve skamnore, përkujdesje ndaj fëmijëve e në theks të veçantë përkujdesje ndaj fëmijëve jetim, vendosja e kujdestarisë, bashkëpunimi me OJQ, bashkëpunimi me Gjykata, Policinë, Shkolla etj.

Performancë:

Numri i të <i>punësuarve/ave</i>	3		3		3	
Sipas gjinisë (femra-meshkuj)	1	2	1	2	1	2

Kuantitative	2024	2025	2026
1. Ofrim të shërbimeve sociale të menjëhershëm për rastet e kërkuara, 2. Vizita familjare dhe këshillime psiko-sociale, 3. Trajtim personave me sjellje Asociale, 4. Edukim rreth dukurive negative, 5. Identifikimi i familjeve skamnore, 6. Bashkëpunim me OJQ dhe institucionet tjera, 7. Infrastruktura (objekti).	Gjatë gjithë vitit	Gjatë gjithë vitit	Gjatë gjithë vitit
Kualitative	2024	2025	2026
1. Planifikimi, 2. SWOT Analiza- Analiza kërkimore, 3. Auditi social, 4. Hulumtimet.	Niveli i kualitetit varet nga përgatitja profesionale e stafit	Niveli i kualitetit varet nga përgatitja profesionale e stafit	Niveli i kualitetit varet nga përgatitja profesionale e stafit

Informata mbi udhëheqësin:

Amir Bushi, Udhëheqës i QPS-së

DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT

Deklarata e Misionit: DAKRS ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj në bazë të ligjit lidhur me organizimin e Arsimit për *nxënës/e* vajza dhe djem. Nxiti barazinë me mundësinë për të ndjekur arsimin në të gjitha nivelet e Komunës, Gjithëpërfshirje në arsim, në zhvillimin dhe aftësimin e personelit për mësim sa më cilësor.

Deklarata e Vizionit: Pos mundësisë për ndjekjen e arsimit, nxiti edhe bashkëpunimin midis *mësimdhënësve/eve*, prindërve, *nxënësve/eve* dhe Institucioneve Arsimore.

Deklarata e Qëllimit: Arritja e standardeve sa më të larta në sferën e arsimit.

Performancë:

Numri i të <i>punësuarve/ave</i>	124		124		124	
Sipas gjinisë (femra-meshkuj)	57	83	57	83	57	83

Kuantitative			
1.Numri i <i>nxënësve/eve</i> në arsimin Parashkollor (çerdhe),	42	55	60
2.Numri i paraleleve (grupeve) në arsimin parashkollor,	5	5	5
3.Numri i <i>edukatoreve/ëve</i> në arsimin parashkollor,	5	5	5
4.Numri i stafit teknik,	2	3	3
5.Numri i <i>nxënësve/eve</i> në arsimin Parafillor,	138	138	138
6.Numri i paraleleve në arsimin Parafillor,	5	5	5
7.Numri i <i>edukatoreve/ëve</i> ,	5	5	5
4.Numri i stafit teknik,	0	1	1
9.Numri i <i>nxënësve/eve</i> në arsimin fillor	1,369	1,370	1,370
10.Numri i shkollave në arsimin fillor,	5	5	4
11.Numri i paraleleve në arsimin fillor,	62	62	61
12.Numri i <i>arsimtarëve/eve</i> në arsimin fillor,	82	82	82
13.Stafi administrativ teknik,	13	13	13
14. <i>Nxënës/e</i> në arsim të mesëm,	306	300	300
15.Shkolla në arsim të mesëm,	1	1	1
16.Paralele në arsim të mesëm,	10	9	9
17. <i>Mësimdhënës/e</i> në arsim të mesëm.	19	19	19
Kualitative	2024	2025	2026

1. Të siguroj kushte optimale që procesi edukativo-arsimor dhe kultura të ngritet në nivelin më të lartë të zhvillimit.	100%	100%	100%
---	-------------	-------------	-------------

Informata mbi udhëheqësin:

Hisni Luri, Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 4747 2023

DATA :	08.06.2023
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hani të Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore për Komunën e Hani të Elezit 2022 me numër protokoli 748 të datës 19.05.2023


Të nderuar,

Gjeni të bashkangjitur Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore për Komunën e Hani të Elezit 2022 me numër protokoli 748 të datës 19.05.2023

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2022

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Liqjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetin.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Hanit të Elezit (KHE), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Hanit të Elezit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- C1 Zotimet e mjeteve dhe urdhërblerjeve në SIMFK pas pranimit të faturave.
B1 Vonesa në pagesën e obligimeve financiare.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbylljen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

ZKF është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, ZKF është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbylljen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Hanit të Elezit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Hanit të Elezit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Hanit të Elezit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk pëmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Hanit të Elezit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Hanit të Elezit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Keto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 5 rekomandime, prej tyre 1 është rekomandim i ri, 2 të përsëritura dhe 2 pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja C1 - Zotimet e mjeteve dhe urdhërblereve në SIMFK pas pranimi të faturave

Gjetja Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF-Shpenzimi i parasë publike, përcakton procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave. Nga kjo, kërkohet që zotimi dhe urdhërblerja të paraprijë pranimi të punëve, mallrave dhe shërbimeve, si dhe pranimi të faturës.

Në pesë pagesa për Mallra e Shërbime, në vlerë totale 23,893€, zotimi i mjeteve dhe përgatitja e urdhërblereve në SIMFK ishte bërë me vonesë, përkatësisht pas pranimi të furnizimeve dhe faturave. Ndërsa në shtatë⁵ pagesa tjera, në vlerë totale 62,269€, tre nga to për mallra dhe shërbime dhe katër nga investimet kapitale, ndonëse mjetet ishin zotuar me kohë në SIMFK, urdhërbleret ishin përgatitur me vonesë apo pas pranimi të faturave. Vonesat ishin nga 1 deri 84 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në zotimin e mjeteve dhe përgatitjen e urdhërblereve me kohë në SIMFK.

Ndikimi Përgatitja e zotimit dhe urdhërblereve me vonesë mund të vështirësojë procesin e menaxhimit financiar dhe ekzekutimin me kohë të pagesave ndaj kontraktuesve.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që procesit të blerjeve të paraprijë zotimi i mjeteve financiare në SIMFK, dhe të vazhdohet më tej me përgatitjen e urdhërbleres për punët, furnizimet apo shërbimet e kontraktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare

Gjetja LMFPF dhe Rregulla financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës.

Në pesë pagesa për shërbime kontraktuese tjera, kompjuter më pak se 1,000€, mirëmbajtja e veturave, mirëmbajtja e auto rrugëve dhe karburant për vetura në vlerë totale 24,609€, kemi identifikuar vonesa në ekzekutimin e faturave përtej afatit të përcaktuar. Vonesat ishin nga 11 deri 60 ditë pas afatit të përcaktuar prej 30 ditëve.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin dhe procesimin e pagesave.

Ndikimi Mos pagesa me kohë e obligimeve financiare rritë rrezikun e ankesave apo padive të mundshme nga kontraktuesit, dhe kjo mund të shkaktojë kosto shtesë financiare për Komunën.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimi të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë shpenzimet komunale në vitin 2022 ishte 478,460€, prej tyre ishin shpenzuar 464,300€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, furnizime për zyre dhe pajisje, mirëmbajtje të Infrastrukturës rrugore dhe objekteve, derivate, shpenzime të telefonisë dhe shpenzime të shërbimeve komunale.

Çështja A1 - I e kalime në furnizim nga sasitë e kontraktuara

Gjetja Me kontratën publike nr. 659-22-2575-1-2-1 për furnizim me material administrativ dhe shtypi jashtë listës së AQP-së për nevojat e institucioneve të komunës, shollave, QKMF, çerdhes, përveç kushteve tjera, përmes specifikacionit të furnizimeve janë përcaktuar sasitë e kontraktuara për secilin pozicion.

Te pagesa për furnizim me material administrativ në vlerë 5,264€, kemi identifikuar që për 16 pozicione/produkte kishte tejkalime të sasive të furnizimit në krahasim me sasitë e kontraktuara. Tejkalimet e sasisë për pozicione të ndryshme ishin nga 6 njësi deri në 5,006 njësi, ndërsa vlera financiare e tejkalimit në total është 1,608€.

Kjo ka ndodhur për shkak se në procesin e planifikimit të nevojave, njësi kërkuese nuk ka analizuar apo planifikuar drejtë nevojat reale për furnizime.

Ndikimi Tejkalimet e furnizimeve për disa produkte mund të pamundësojnë furnizimin e produkteve tjera të kontraktuara me arritjen e vlerës totale të kontratës.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese analizojnë dhe planifikojnë drejtë nevojat vjetore për furnizim, dhe se kontratat realizohen sipas kushteve dhe sasisë së kontraktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 87,000€ dhe nga to janë shpenzuar 85,967€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionet për përfitues individual dhe organizata jo qeveritare në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Çështja C2 - Përbërja jo e plotë e komisionit dhe përdorimi jo standard i formularëve në procesin e mbështetjes financiare të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ)

Gjetja Me Rregulloren MF-Nr-04/2017 për procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), janë përcaktuar formularët standard që duhet të përdoren nga Organizatat Buxhetore (OB) me rastin e vlerësimit të kërkesave për mbështetje financiare. Gjithashtu, me nenin 8, kërkohet që komisioni vlerësues të përbëhet nga pesë anëtarë.

Në tre procese të subvencionimit të OJQ-ve, SH.K.A. Sharri për projektin në vlerë 3,000€, K.F. Sharri për projektin në vlerë 11,000€, dhe Klubi i Mundjes Dardania për projektin në vlerë 3,000€, anëtarët e komisionit nuk kanë përdorur formularët standard të vlerësimit të kërkesave për financim, dhe se komisioni i vlerësimit të kërkesave ishte i përbërë me vetëm tre anëtarë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos informimit të mjaftueshëm nga drejtoria dhe anëtarët e komisionit përkatëse lidhur me kërkesat dhe procedurat e rregullores për subvencionimin e OJQ-ve.

Ndikimi Mangësitë e tilla mund të ndikojnë që kërkesat për financim të mos shqyrtohen si duhet nga komisioni vlerësues, apo të rrisin mundësinë e parregullsive gjatë procesit të subvencionimit.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë që komisioni vlerësues të përdorë formularët standard të vlerësimit të kërkesave për subvencionim, si dhe përbërja e komisionit vlerësues të jetë sipas kërkesave të rregullores për financimin publik të OJQ-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e Arkëtueshme të shpalosura në PFV e vitit 2022 janë 716,602€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë dhe tokë, taksat për ushtrimin e veprimtarisë, dhe të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike.

Çështja B2 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenin 26 të ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimorë të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë eurove (10€). Gjithashtu, neni 27 përcakton që, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendrike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna ka shpalosur në pasqyrën financiare të vitit 2022 llogari të arkëtueshme në vlerë totale 716,602€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë në vlerë 440,629€ apo rreth 62%, taksat për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 266,032€ apo rreth 37%, dhe shfrytëzimi i pronës publike në vlerë 9,940€ apo rreth 1%. Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje, dhe në krahasim me vitin paraprak rritja e tyre është 73,455€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në mbledhjen e të hyrave, mos ndërmarrja e veprimeve ligjore ndaj debitorëve, si dhe nga bartja e borxheve të vjetra nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon negativisht në fondin buxhetor të komunës, me reflektim në financim dhe realizim të projekteve komunale.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese, me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Pershkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,759,758	2,997,869	2,704,228	2,634,282	3,087,212
Grante Qeveritare - Buxheti	2,378,411	2,417,451	2,318,493	2,253,482	2,710,574
Financimi përmes huamarrjes	0	20,286	20,286	6,157	17,955
Të bartura nga viti i kaluar	0	72,738	62,486	57,002	84,716
Të hyrat vetanake	381,347	381,347	243,823	253,181	187,496
Donacionet vendore	0	30	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	106,018	59,140	64,459	86,471

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 238,111€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 72,738€, donacioneve të huaja në vlerë 106,047€, financimeve nga huamarrja në vlerë 20,286€, dhe vendimeve të qeverisë me qëllim rimëkëmbjen ekonomike në vlerë 39,040€.

Në vitin 2022 Komuna e Hanit të Elezit ka shpenzuar 91% të buxhetit përfundimtar ose 2,704,228€, me një ulje prej 8% në krahasim me vitin 2021. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	2,759,758	2,997,869	2,704,228	2,634,282	3,087,212
Pagat dhe mëditjet	1,756,083	1,782,140	1,604,068	1,644,863	1,577,267
Mallrat dhe shërbimet	385,975	410,760	396,616	348,741	382,355
Komunalitetë	67,700	67,700	67,684	64,900	61,959
Subvencionet dhe transferet	80,000	87,000	85,967	72,465	155,946
Investimet Kapitale	455,000	650,270	458,992	503,312	909,685
Rezervat	15,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për Paga e Mëditje është rritur për 26,057€. Rritja është rezultat i pranimeve nga financimet e huamarrjes në shumë 20,286€ me qëllim rimëkëmbjen ekonomike të dedikuara për sektorin e shëndetësisë, donatorëve të jashtëm në vlerë 3,881€ dhe vendimeve të qeverisë në shumë 1,890€.
- Buxheti i Mallrave dhe Shërbimeve është rritur për 24,784€. Rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar në vlerë 21,800€ dhe 2,984€ nga donatorët e jashtëm.
- Buxheti i Subvencioneve dhe Transfereve është rritur për 7,000€ nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar.
- Buxheti për Investime kapitale është rritur për 195,270€. Rritja është ndikuar nga pranimi i 99,182€ nga donatorët e jashtëm, 43,938 nga bartja e të hyrave nga viti i kaluar, 15,000€ nga transferi i mjeteve prej kategorisë së rezervave, dhe 37,150€ nga vendimi i qeverisë. Përkundër një rritje të buxhetit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit, vetëm 71% e buxhetit ishte shpenzuar. Programi i Investimeve Publike përfshin 14 projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe 14 projekte të reja për vitin aktual.

Komuna e Hanit të Elezit ka përfituar nga programi i rimëkëmbjes ekonomike mjete në vlerë 21,789€, të cilat janë shfrytëzuar për financimin e pagave dhe mëditjeve për shërbimet e shëndetësisë primare.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e planifikuara për vitin 2022 ishin 381,347€, ndërsa janë realizuara 334,002€ apo 88% e planit. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë dhe tokë, taksat për ushtrimin e veprimtarisë, licencat, participimet, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, etj.

Gjithashtu, në vitin 2022 Komuna e Hanit të Elezit ka përfituar 24,670€ të hyra nga gjobat në trafik dhe 156€ nga Agjencia e Pyjeve. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës së Hanit të Elezit i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për tu shpenzuar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	381,347	381,347	334,002	316,657	230,239
Të hyrat tatimore	225,572	225,572	163,301	139,134	97,071
Të hyrat jo tatimore	155,775	155,775	170,700	177,523	133,168

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2021 të Komunës së Hanit të Elezit ka rezultuar me 9 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna, si dhe ka përgatitur raportot periodiko lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2021. Raporti i auditimit për vitin 2021 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në kuvendin komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, 5 rekomandime janë zbatuar; 2 ishin në proces dhe 2 të tjera nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që të dhënat financiare për buxhetin dhe shënimet shpjeguese të prezantohen të plota dhe të sakta në pasqyrat financiare të vitit 2022, sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	PVF dhe shënimet shpjeguese janë prezantuar të plota dhe të sakta.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestininim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Shpenzimet janë regjistruar në kodet përkatëse ekonomike.	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i rekrutimit të personelit zhvillohet sipas LZP-së, dhe se njoftimet dhe procedurat e rekrutimit të zhvillohen përmes ueb faqes së konkurrimeve të SIMENJ-së dhe ueb faqes së komunës. Komisioni i pranimit të përzgjedh vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me konkurs.	Procedurat e rekrutimit janë zhvilluar sipas procedurave dhe rregullave përkatëse.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni i vlerësimit të tenderëve rekomandon për kontratë vetëm ofertuesit me të suksesshëm që plotësojnë kriteret e përcaktuara me njoftimin për kontratë.	Nuk ka pasur ndonjë çështje si në vitin e kaluar.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që afatet kohore për thirrjen publike dhe përbërja e komisionit vlerësues të jenë sipas kërkesave ligjore. Të caktohen zyrtarët përgjegjës për monitorim, dhe të kërkohej nga përfituesit të dorëzojnë raporte financiare dhe narrative. Plani vjetor i mbështetjes financiare dhe Raporti vjetor të përgatiten dhe të njëjtat t'i dërgohen me kohë zyrës për qeverisje të mirë në kuadër të ZKM-së.	Ndonëse disa çështje rreth procesit të subvencionimit janë adresuar si është shpallja publike, dorëzimi i raporteve financiare nga përfituesit, megjithatë ende janë prezente mangësi në procesin e subvencionimit.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që nënshkrimi të kontratës të paraprijë zotimi i mjeteve financiare në SIMFK, dhe të pasohet më tej me përgatitjen e urdhërblërjes për furnizimet apo shërbimet e kontraktuara.	Zotimet e mjeteve janë bërë para nënshkrimit të kontratave, por zotimet e mëvonshme dhe urdhërblërjet gjatë zbatimit të kontratës janë krijuar me vonesë.	Pjesërisht i zbatuar
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se programi e-pasuria fillon së aplikuari, dhe se të gjitha pasuritë regjistrohen dhe klasifikohen si duhet në regjistrin e pasurisë. Gjithashtu, të sigurohet përmbushja e kërkesës ligjore për inventarizimin e pasurisë para përgatitjes së pasqyrave financiare.	Ka filluar aplikimi i programit e-pasuria, pasuritë janë regjistruar, dhe është bërë inventarizimi i pasurisë.	I zbatuar
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.	Saldo e LL/A është në rritje.	Nuk ka filluar zbatim

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

9.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të regjistrohen brenda afatit dhe obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.	Edhe këtë vit kemi raste të mos pagesës me kohë të obligimeve.	Nuk ka filluar zbatimi
----	-----------------------	---	--	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Arben Hundozi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANËT E ELEZIT



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për
zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komonës së Hanit të Elezit për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Mehmet Ballazhi

Kryetari i Komitetit të Hanit të Elezit

M. Ballazhi

Data: 12.04.2023



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit..

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe përvazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Furnizim me dru, pajisje tjera mjekësore, dhe pajisje tjera nën 1,000€, Rregullimi i taximit në QKMF, vendosja e tabelave dixhitale në rrugën Adem Jashari, ndërtimi i shkollëve emergjente në objektin arsimor, dhe riparimi i rrugëve dhe trotuareve.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr.04/ 4749/2023

DATA:	08.06.2023
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA:	Lindita Ballazhi <i>L Ballazhi</i> Drejtoreshë e Drejtorisë Buxhet dhe Financa
LËNDA:	Plani i veprimit të Komunës për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022



Të nderuar,

Bazuar në nenin 14 të Rregullores së Punës për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, Komuna Hani i Elezit ka përgatitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin 2022 të dalura nga Raporti i Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Po ju dërgojmë:

- **Plani i veprimit të Komunës për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022**

Duke e marrë në konsideratë raportin e auditimit të ZKA së në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes planit të veprimit.

Po ashtu, në kohë reale do të dorëzojmë Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të muajit tetor 2023 dhe prill 2024 do të diskutojmë në Kuvendin e Komunës për progresin lidhur me zbatimin e planit të veprimit për rekomandimet e auditimit.

Me respect,

Nr.	Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës / Drejtorja	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Çështja A1 - Tejkallime në furnizim nga sasitë dhe komunalitet	Me kontratën publike nr.659-22-2575-1-2-1 për furnizim me material administrativ dhe shtypi jashtë listës së AQP së për nevojat të institucioneve të komunës, shkollave, QKMF, çerdhesh, përveç kushteve tjera, përmes specifikacionit të furnizimeve janë përcaktuar sasitë e kontraktuara për secilin pozicion. Te pagesa për furnizim me material administrativ në vlerë prej 5.264.00 €, kemi identifikuar që për 16 pozicione/produkte kushte tejkallim të sasive të furnizimit në krahasim me sasitë e kontraktuara. Tejkallimet e sasive për pozicione të ndryshme ishin nga 6 njësi deri në 5.0006 njësi. Ndërsa vlera financiare e tejkallimit në total është 1.608.00€. Kjo ka ndodhur për shkak se në procesin e planifikimit të nevojave, njësitë kërkuese nuk ka analizuar apo planifikuar drejtë nevojat reale për furnizime.	Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese analizojnë dhe planifikojnë drejtë nevojat vjetore për furnizim, dhe se kontratat realizohen sipas kushteve dhe sasive të kontraktuar.	Do të mundohemi që të mos i tejkalojmë planifikimet.	Njësitë kërkuese. Zyra e Prokurimit	Qershor-Dhjetor 2023	
2	Çështja B1 – Vonësia në	LMFPP dhe Rregulla financiare	Kryetari duhet të sigurojë se	Do të mundohemi që	Mungesa e mjeteve dhe	Qershor-Dhjetor	

pagesën e obligimeve financiare	Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Në pesë pagesa për shërbime kontraktuese tjera, kompjuter më pak se 1.000 €, mirëmbajtja e veturave, mirëmbajtja e autorrugëve dhe karburant për vetura në vlerë totale 24,609 €, kemi identifikuar vonesa në ekzekutimin e faturave përtej afatit të përcaktuar. Vonesat ishin nga 11 deri 60 ditë pas afatit të përcaktuar prej 30 ditëve. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin dhe procesimin e pagesave.	obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturës.	vonesat të eliminohen dhe të shtohen kontrollet në menaxhimin dhe procesimin e pagesave.	njësitë përgjegjëse	2023	
Çështja B2 – Rritje e llogarive të arkëtueshme	Sipas nenit 26 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbartues kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë eurove (10 €). Gjithashtu, neni 27 përcakton që, nëse një tatimpagues apo	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese, me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Do të mundohemi të shtojmë kontrollin në mbledhjen e të hyrave, ndërmarrja e veprimeve ligjore ndaj debitorëve.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotjtje të Mjedisit	Qershor-Dhjetor 2023	

debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna ka shpalosur në pasqyrën financiare të vitit 2022 llogari të arkëtueshme në vlerë totale /16.602 €. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë në vlerë 440.629 8 apo rreth 62%, taksa për ushurin e veprimtarisë në vlerë 266,032 € apo rreth 37%, dhe shfrytëzimi i pronës publike në vlerë 9.940 € apo rreth 1%. Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje, dhe në krahasim me vitin paraprak rritja e tyre është 73.455 €.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në mbledhjen e të hyrave, mos ndërmarrja e veprimeve ligjore ndaj debitorëve, si dhe nga bartja e borxheve të vjetra nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike.

4

Çështja C1 – Zotimet e mjeteve dhe urdhërblertjeve në SIMFK pas pranimit të faturave

Neni 22 i rregullës Financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i parasj publike, përcakton procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave. Nga kjo,

Kryetari duhet të sigurojë që porcesit të blertjeve t'i paraprijë zotimi i mjeteve financiare në SIMFK, dhe të vazhdohet më tej me përgatitjen e urdhërblertjes për

Do të shtojmë kontrollin në zotimin e mjeteve dhe do të bëhet përgatitja e urdhërblertjeve me kohë në SIMFK.

Zyra e Prokurimit, Drejtoria Buxhet dhe Financa

Qershor-Dhjetor 2023

kërkohej që zotimi dhe urdhërblerja t'i paraprijë pranimi të punëve, mallrave dhe shërbimeve, si dhe pranimi të faturës. Në pesë pagesa për Mallra e Shërbime, në vlerë totale 23,893 €, zotimi i mjeteve dhe përgatitja e i urdhërbljerjeve në SIMFK ishte bërë me vonesë, përkatësisht pas pranimi të furnizimeve dhe faturave. Ndërsa në shtatë pagesa tjera në vlerë totale 62,269 €, tre nga to për Mallra dhe Shërbime dhe katër nga investimet kapitale, ndonëse mjetet ishin zotuar me kohë në SIMF, urdhërbljerjet ishin përgatitur me vonesë apo pas pranimi të faturave. Vonesat ishin nga 1 deri 84 ditë. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në zotimin e mjeteve dhe përgatitja e urdhërbljerjeve me kohë në SIMFK.	punët, furnizimet apo shërbimet e kontraktuara.				
Me Rregulloren MF-Nr-04/2017 për procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) janë përcaktuar formularët standard që duhet të përdoren nga Organizatat Buxhetore (OB) me rastin e vlerësimit të kërkesave për mbështetje financiare. Gjithashtu, me nenin 8, kërkohej që	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni vlerësues të përdorë formularët standard të vlerësimit të kërkesave për subvencionim, si dhe përbërja e komisionit vlerësues të jetë sipas kërkesave të rregullores për financimin publik të OJQ-ve.	Do të sigurojmë që komisioni vlerësues të përdorë formularët standard të vlerësimit të kërkesave për subvencionim, do të bëhet informimi i mjaftueshëm nga drejtoria dhe anëtarët e komisionit përkatës lidhur me kërkesat dhe	Zyra e Personelit	Qershor-Dhjetor 2023	

komisioni vlerësues të përbëhet nga pesë anëtarë.

Në tre procese të subvencionimit të OJQ-ve, SH.K.A "Sharri" për projektin në vlerë 3,000 €, K.F "Sharri" për projektin në vlerë 11,000€, dhe Klubi i Mundjes "Dardania" për projektin në vlerë 3,000 \$, anëtarët e komisionit nuk kanë përdorur formularët standard të vlerësimit të kërkesave për financim, dhe se komisioni i vlerësimit të kërkesave ishte i përbërë me vetëm tre anëtarë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos informimit të mjaftueshëm nga drejtoria dhe anëtarët e komisionit përkatës lidhur me kërkesat dhe procedurat e rregullores për subvencionimin e OJQ-ve.

procedurat e rregullores për subvencionimin e OJQ-ve.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/4957/2023

DATA :	16.06.2023
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale



Të nderuar,

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L-198 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, neni 3, paragrafi 1.32, 1.43, neni 17, paragrafi 1, Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30, paragrafi 30.2, Drejtoria për Buxhet dhe Financa kërkon aprovimin nga Kuvendi Komunal të kërkesës për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Rialokimi i mjeteve për komunën e Hanit të Elezit në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej 117,654.65 € nga fondi 10 dhe 21, ku nga fondi 10 mjetet për rialokim arrijnë vlerën prej 74,029.65 € ndërsa prej fondit 21 mjetet për rialokim arrijnë vlerën prej 34,625 €

Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, burimi i financimit (10) dhe (21).

Në kuadër të nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620).

Rialokohen nga projektet:

1. "Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc", kodi (41635), në shumë prej 5,000.00 €, fondi burimor (10),
2. "Vendosja e ekranit për prezantimin e rezultateve të ndotjes së ajrit në Rr. Nuri Bushi", kodi (52906), në shumë prej 5,000.00 €, fondi burimor (10),
3. "Ndërtimi i mbikalimeve në Rr. Martirët Bushi dhe Rr. Lepenci", kodi (53429), në shumë prej 7,096.00 €, ku 2,096 € fondi burimor (10) dhe 5,000 € fondi burimor (21),
4. "Rregullimi i shtigjeve për këmbësor dhe çiklistë përgjatë lumit Lepenc (Uji i thartë - Kulla me çeshme)", kodi (51363), në shumë prej 25,000.00 €, ku 15,000 € fondi burimor (10) dhe 10,000 € fondi burimor (21),
5. "Asfaltimi i rrugës Gorancë – Krivenik", kodi projektit (47270), në shumë prej 47,000.00 €, ku 18,375 € fondi burimor (10) dhe 28,625 € fondi burimor (21).

Rialokohen në projektet:

1. "Rregullimi i prockave dhe i kanalizimeve atmosferike në zonën urbane Rr. Adem Jashari dhe fshatin Paldenicë", kodi (51589), në shumë prej 32,000.00€,
2. "Ndërtimi i parkut te rruga Lepenci", kodi (53366), në shumë prej 49,000.00 €,
3. "Ndërtimi i trotoareve për këmbësor në Han të Elezit në Rr. Adem Jashari, Udha e Shkronjave, Driton Loku, Paldenicë", kodi (53370), në shumë prej 8,096.00 €.

Në kuadër të nën-programit Arsimi fillor, i mesëm i ulët (94020), kodi funksional (0912).

Rialokohet nga projekti:

“Ndërtimi i objektit të SHFMU në Lagjen e Re”, kodi projektit (52945), në shumë prej 28,558.65 €, fondi burimor (10).

Rialokohet në projektin:

“Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML - Dardania, SHFMU - Ilaz Thaçi, SHFMU - Këshijella e Diturisë dhe SHMFU - Veli Ballazhi”

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 504/2023

DATA :	19.05.2023
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Plotësimi-ndryshim të Vendimit Nr.04/P116 Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga 2022 në vitin 2023

Të nderuar,

Përmes kësaj kërkesë, ju njoftojmë për bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të vitit 2022 dhe bartjen e tyre në vitin 2023, nëpër kategoritë ekonomike dhe nën-programet buxhetore të komunës së Hanit të Elezit.

Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2022 kanë qenë në shumë prej 358,827.93 €, prej tyre janë të shpenzuara 243,822.54 €, kurse për bartje kanë mbetur 115,005.39 €.

Pra në total, të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2022 janë në shumën prej 115,005.39 €, të cilat i bartim në vitin 2023 dhe i shpërndajmë nëpër këto kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon:

- ✓ mallra dhe shërbime në shumë prej 10,676.02 €.
- ✓ subvencione dhe transfere në shumë prej 1,033.00 dhe
- ✓ shpenzime kapitale në shumë prej 103,296.37 €.

Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime

- ✓ Administrata dhe Personel (16335), kodi funksional (0133), shuma prej 39.25 €
- ✓ Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050), kodi funksional (0721) shuma prej 6,753.84 €.
- ✓ Arsimi Parafillor-Çerdhja (92890), kodi funksional (0911), shuma prej 3,882.93 €.

Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe Transfere

- ✓ Zyra e Kryetarit (16035), kodi funksional (0111) shuma prej 1,033.00 €.

Në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale

- **Parandalimi dhe Inspektimi i zjarrit (18444):**

Parandalimi dhe Inspektimi i zjarrit (18444), kodi funksional (0320), në shumë prej 19,000.00 €, në këto projekte:

“Rregullimi i kanalit të ujitjes në vendin Lloka në Seçishtë” (51616) në shumë prej 10,000.00 €,

“Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe vendosja e ujëmatësve në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit” (53773), në shumë prej 9,000.00 €.

- **Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480):**

Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej 77,840.17 €,

“Rregullimi i parkut në rrugën “Isa Berisha” (asfaltim, trotuar, ndiçim publik, gjelbërim), (51085) në shumë prej 25,000.00 €,

“Ndërtimi i parkut te rruga Lepenci” (53366), në shumë prej 19,000.00 €,

“Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik”, (53471), në shumë prej 9,000.00 €.

“Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve të fsh: Paldenicë, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik (53484) në shumë prej 24,840.17 €,

- **Arsim fillor, i mesëm, i ulët (94020):**

Arsim fillor, i mesëm, i ulët (94020), kodi funksional (0912), në shumë prej 6,456.20 €, në projektin:

“Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML – Dardania, SHFMU – Ilaz Thaçi, SHFMU – Kështjella e Diturisë dhe SHMFU – Veli Ballazhi (53774), në shumë prej 6,456.20 €.

Tabela 1. Shpërndarja e mjeteve nëpër nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike

Kodi i nënprogramit	Nën-Programet Buxhetore	Mallrat dhe shërbimet	Subvencionet dhe transferet	Investime Kapitale	Totali
16035	Zyra e Kryetarit	-	1,033.00	-	1,033.00
16335	Administrata dhe Personel	39.25	-	-	39.25
18444	Parandalimi dhe inspektimi i zjarrit	-	-	19,000.00	19,000.00
66480	Planifikimi urban dhe inspeksioni	-	-	77,840.17	77,840.17
75050	Shërbimet e Shëndetësisë Primare	6,753.84	-	-	6,753.84
92890	Arsimi Parafillor-Çerdhja	3,882.93	-	-	3,882.93
94020	Arsim fillor, i mesëm, i ulët	-	-	6,456.20	6,456.20
	Totali	10,676.02	1,033.00	103,296.37	115,005.39

Tabela 2. Shpërndarja e mjeteve nëpër nën-programet buxhetore në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzime kapitale, në projektet si vijon:

SHPENZIMET KAPITALE TOTALE 2023	103,296.37
Parandalimi dhe inspektimi i zjarrit	19,000.00
Rregullimi i kanalit të ujitjes në vendin Lloka në Seçishtë	10,000.00
Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe vendosja e ujëmatësve në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit	9,000.00
Planifikimi Urban dhe Inspeksioni	77,840.17
Rregullimi i parkut në rrugën "Isa Berisha" (asfaltim, trotuar, ndriçim publik, gjelbërim)	25,000.00
Ndërtimi i parkut të rruga Lepenci	19,000.00
Shtimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pusteni, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik	9,000.00
Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve të fshatit Paldenicë, Pusteni, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik	24,840.17
Arsim fillor, i mesëm, i ulët	6,456.20
Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML - Dardania, SHFMU - Ilaz Thaçi, SHFMU - Kështjella e Diturisë dhe SHMFU - Veli Ballazhi	6,456.20

Me respekt,



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.4746/2023

DATA:	08.06.2023
PËR:	Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës.
NGA:	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Florim Shkreta
LËNDA:	Shkresë përcjellëse: Propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim Propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.

Me respekt



